

# RAPORT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË MAQEDONI PËR VITIN 2017

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Republika e Maqedonisë është demokraci parlamentare. Presidenti i zgjedhur nga qytetarët është udhëheqës i shtetit dhe komandant suprem i forcave të armatosura. Parlamenti njëdhomësh ushtron pushtetin ligjvënës. Në muajin dhjetor 2016 u mbajtën zgjedhjet parlamentare ndërkaq ato presidenciale u mbajtën në vitin 2014. Në raportin përfundimtar për zgjedhjet parlamentare, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE / ODIHR) ka deklaruar se zgjedhjet kanë qenë transparente, janë administruar mire dhe në mënyrën e duhur, por u zhvilluan në "rrethana ku mungonte besimi publik në institucionet dhe në establishmentin politik" dhe dështuan në përmbushjen e disa detyrimeve të rëndësishme të OSBE-së, për një proces demokratik zgjedhor. Raporti përfundimtar i OSBE / ODIHR mbi zgjedhjet presidenciale të vitit 2014 vuri në dukje se zgjedhjet respektonin liritë themelore të qytetarëve, por se nuk kishte ndarje të mjaftueshme midis veprimtarisë partiake dhe shtetërore.

Autoritetet civile kanë ruajtur kontrollin efektiv mbi forcat e sigurisë.

Në 31 maj, Parlamenti zgjodhi Qeverinë e re të kryesuar nga partia e mëparshme e opozitës Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM) duke i dhënë fund një proces të formimit të qeverisë që zgjati me muaj. Më 27 prill, pasi shumica e deputetëve të parlamentit zgjodhën Talat Xhaferin si kryetar, protestuesit sulmuan parlamentin, ku si rezultat u lënduan shtatë deputet. Mediat raportuan se efektivët e Ministrisë së Brendshme kanë ndihmuar protestuesit dhe nuk kanë ushtruar detyrën e tyre për të mbrojtur deputetët. Ministria ndëshkoi efektivët për mos kryerjen e detyrave të tyre, duke përfshirë edhe shkarkimin e tetë oficerë.

Problemet më të rëndësishme për të drejtat e njeriut kanë qenë raportet e torturës nga rojet e burgut; ndërhyrje në privatësi; dhuna kundër gazetarëve; mungesa e pavarësisë së gjyqësorit; korrupsioni; dhe dhuna kundër lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transeksualëve dhe interseksioneve (LGBTI).

Qeveria bëri disa hapa për të hetuar, ndjekur dhe dënua zyrtarët që kanë bërë abuzime, duke përfshirë efektivët e policisë që janë fajtorë për përdorimin e forcës së tepërt, por mosndëshkimi edhe më tej ka vazhduar të mbetet si problem i gjithanshëm. Mes 15 prillit dhe 15 shtatorit, Prokuroria Speciale, duke hetuar akuzat për korrupsion midis 2008 dhe 2015, ka ngritur 18 aktakuza kundër 120 të pandehurve, të akuzuar për 168 vepra penale dhe ka hapur shtatë hetime kundër 25 të dyshuarve. Po ashtu ngriti 142 hetime paraprake për sjellje në dukje kriminale në lidhje me ose që rrjedhin nga përmbajtja e komunikimeve të përgjuara ilegalisht.

### **Pjesa 1. Respektimi i integritetit të personit, duke e përfshirë edhe lirinë nga:**

#### **a. Privimi arbitrar nga jeta ose vrasje të tjera të paligjshme ose për motive politike**

Nuk ka pasur raporte që Qeveria ose përfaqësuesit e saj të kenë kryer vrasje arbitrare ose të paligjshme.

#### **b. Zhdukje**

Nuk ka pasur raporte zhdukjesh, nga ose në emër të autoriteteve qeveritare.

### **c. Tortura dhe trajtimet ose ndëshkimet tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.**

Ligji i ndalon këto praktika, por ka pasur raporte sipas të cilave policia ka abuzuar me të ndaluarit dhe të burgosurit dhe ka ushtruar forcë të tepërt. Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale (SSP) i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka raportuar 11 ankesa kundër efektivëve policorë, për ushtrim të forcës së tepërt. Ka ndërmarrë masa disiplinore kundër dy efektivëve për këto vepra. Nga janari deri në shtator, Avokati i Popullit ka pranuar nëntë ankesa kundër policisë për përdorim të paligjshëm ose të tepruar të forcës.

Më 12 tetor, Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT) lëshoi një raport për vizitën e tij në dhjetor 2016 në vend. Gjatë vizitës, KPT raportoi se kishte marrë një numër pretendimesh të qëndrueshme për keqtrajtimin e qëllimshëm fizik të të burgosurve nga rojtarët e burgjeve në burgun e Idrizovës, burgu më i madh i vendit. Keqtrajtimi i raportuar përbëhej kryesisht nga shpulla, goditje me grusht, shkelmime dhe goditje në pjesë të ndryshme të trupit dhe pretendohet ky keqtrajtim të jetë përdorur nga stafi i burgut si një mjet disiplinor, si ndëshkim jozyrtar për shkelje dhe si reagim ndaj kërkesave dhe ankesave të të burgosurve. KPT-ja gjithashtu vuri në dukje se zyrtarët e burgjeve qëllimisht kishin nxitur të burgosurit që të keqtrajtojnë të dënuarit për krime seksuale dhe personat romë, si dhe pretendimet se vetë punonjësit e burgut godisnin të dënuarit për krime seksuale me shkop gome (shih Kushtet e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit). KPT gjithashtu ka njoftuar se kishte marrë disa pretendime për keqtrajtimin e të burgosurve nga rojtarët në burgun e Shtipit.

Në raportin e tij të 12 tetorit, KPT-ja ka deklaruar, "Dhuna në burgun e Idrizovës lidhet në mënyrë integruese me korrupsionin endemik që ka përfshirë tërë burgun dhe implikon zyrtarët e burgjeve, përfshirë zyrtarët e të gjitha klasave deri tek zyrtarët më të lartë dhe edukatorët". Raporti vë në dukje se, "Në Burgun e Idrizovës çdo aspekt i burgimit është në shitje, nga marrja e një vendi në një qeli të denjë, deri te marrja për leje për të shkuar në shtëpi, për ilaçe, për telefonat celularë dhe për drogë." Në një rast të dhunës lidhur me korrupsionin dhe pagesat për rojtarët e burgjeve në burgun e Idrizovës, rojtarët e burgut kishin rrahur rëndë një të burgosur në shtator 2016; KPT ka konfirmuar se rasti ishte nën hetim nga Zyra e Prokurorit Publik të Shkupit.

Në korrik 2016, gjashtë nga 37 personave të pandehur për pjesëmarrje në përlëshjet e armatosura me policinë në Kumanovë të vitit 2015, ku u vranë 18 persona, kanë kërkuar ndihmë mjekësore nga gjykata, duke akuzuar policinë për brutalitet gjatë transportit të tyre nga objektet e paraburgimit në gjykatë. Avokatët e të pandehurve kanë kërkuar shtyrje të pacaktuar të gjykimit, duke pretenduar se "Tortura e të pandehurve është evidente dhe kjo ka ndodhur që nga dita e parë e arrestimit të tyre deri në seancën e fundit." Gjykata ka informuar avokatët e të dyshuarve se raporti mjekësor ka konfirmuar abuzimin fizik të dy të pandehurve duke konstatuar lëndime të lehta. Ish-Ministri i Brendshëm Mitko Çavkov ka pretenduar se hetimi i pretendimeve nuk kishte zbuluar prova të torturës dhe se nuk ishin ngritur padi kundër policëve dhe rojtarëve të burgut të paditur, pavarësisht ankesave të përsëritura dhe thirrjeve për veprim nga ana e avokatit mbrojtës dhe Avokatit të Popullit. Në dhjetor 2016, Ministria e Brendshme ka njoftuar se do të rihapte hetimin. Që nga 1 shtatori, 14 policë dhe roje të burgjeve janë nën hetim për abuzimet e pretenduara. Në tetor, Avokati i Popullit konfirmoi pretendimet për torturë të kryer nga punonjësit e Ministrisë së Brendshme të ngarkuar për transportimin e të pandehurve në gjykatë. Një hetim vazhdoi në lidhje me pretendimin e një të pandehuri se një anëtar i njësitit policor "Tigrat" e kishte dhunuar seksualisht atë.

Gjatë vitit, Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve, një organizatë joqeveritare për të drejtat e njeriut (OJQ), kishte pretenduar se ka pasur "dhunë institucionale" ndaj individëve romë në burgjet dhe se në disa raste ishin keqtrajtuar persona romë në ambientet e paraburgimit, duke rezultuar në vdekjen e tyre.

### **Kushtet e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit**

Burgjet dhe qendrat e paraburgimit në vend nuk i kanë përmbushur standardet ndërkombëtare dhe në disa raste, sipas KPT-së, kushtet mund të përshkruhen si trajtim çnjerëzor dhe degradues. Korrupsioni endemik, shkalla e lartë e mbipopullimit, keqtrajtimi nga rojet e burgut, dhuna midis të burgosurve, kushtet e pasigurta dhe johigjienike, stafi i pamjaftueshëm dhe trajnimi i pamjaftueshëm i rojeve dhe personelit mbetën probleme serioze, veçanërisht në burgun e Idrizovës, i cili përfshin më shumë se tre të pestat e popullsisë së burgut të vendit.

Kushtet fizike: Kushtet fizike: Vendi ka pasur 11 burgje dhe tre objekte korrektuese për të mitur; në shtatë nga burgjet janë vendosur edhe të paraburgosur në pritje të gjykimit. Burgjet janë paraparë për vendosjen e 2.036 të burgosur, 43 të mitur dhe 450 persona në paraburgim. Më 1 shtator sistemi kishte gjithsej 2.767 individë – 2.507 të burgosur të rritur, 235 të paraburgosur dhe 25 të mitur.

Sipas Zyrës së Avokatit të Popullit, kushtet e vështira ishin shkak për rritjen e asaj që quhet "trajtimi çnjerëzor dhe degradues i të burgosurve dhe të paraburgosurve".

Përveç keqtrajtimit të të burgosurve në burgun e Idrizovës nga ana e personelit të burgjeve (shih seksionin 1.c.), KPT-ja raportoi se dhuna midis të burgosurve është një problem serioz në burg. Në një rast të raportuar, të burgosurit e sapoardhur, të dënuar për vepra seksuale, vazhdimisht ishin goditur me grushte dhe me objekte të rënda (si fshesa) nga grupe të të burgosurve. Personeli i burgjeve njoftohet se nuk ka ndërmarrë ndonjë masë për të mbrojtur këta të burgosur dhe ka pasur pohime se zyrtarët e burgjeve me qëllim kanë nxitur të burgosurit që të keqtrajtojnë të dënuarit për vepra seksuale. Disa të burgosur kanë pretenduar se janë rrahur nga të burgosurit e tjerë, sepse nuk kanë qenë në gjendje të paguajnë borxhet e bëra gjatë burgimit.

Autoritetet e burgut kanë identifikuar mbipopullim si problem kryesor që ka shkaktuar shumë probleme të tjera dytësore, siç janë: kushte joadekuate të banimit për të burgosurit, kujdes të pamjaftueshëm dhe joadekuat shëndetësor, kushte të vështira dhe të përgjithshme të higjienës personale, si dhe kushte sanitare të këqija.

Në burgun e Idrizovës, i ndërtuar për të akomoduar 800 të burgosur por që mbante mbi 1,800 persona, ishte në gjendje veçanërisht të keqe. Në raportin e vet të 12 tetorit, KPT-ja ka vënë në dukje se anekset sanitare ishin në një "gjendje të tmerrshme (të ndyrë, me erë të keqe, të dëmtuara dhe me rrjedhje), shumë nga dushet nuk funksiononin dhe nuk kishte pothuajse asfarë furnizim me ujë të ngrohtë". Në kohën e vizitës së dhjetorit 2016, KPT raportoi se ngrohja punonte vetëm disa orë në ditë. Sigurimi i kujdesit shëndetësor në burgjet e Idrizovës dhe Shkupit ishte i pamjaftueshëm. KPT gjithashtu ka vërejtur se shumë të burgosur vuanin nga kafshimet e insekteve dhe infeksionet si zgjebja.

Personeli i pamjaftueshëm dhe trajtimi joadekuat i rojeve të burgut dhe personelit tjetër vazhdojnë të paraqesin problem në të gjitha objektet.

Administrimi: Në raportin e 12 tetorit, KPT ka konstatuar se nuk ka asnjë sistem funksional të ankesave të brendshme në tri institucionet që kishte vizituar, duke përfshirë edhe burgun e

Idrizovës. Në përgjithësi Avokati i Popullit ka konstatuar se hetimet e autoriteteve korrektuese mbi pretendimet për keqtrajtim dhe abuzimin e të burgosurve kanë qenë joefektive. Shumica e autorëve kanë vazhduar të abuzojnë pa u ndëshkuar dhe kur janë ngritur kallëzime penale, rastet nuk janë trajtuar menjëherë ose në mënyrë efikase. Që nga shtatori, Avokati i Popullit ka marrë 157 ankesa në lidhje me trajtimin në mjediset korrektuese dhe po hetonte 44.

Departamenti për Zbatimin e Sanksioneve ka marrë 14 njoftime për përdorimin e forcës kundër të burgosurve nga policia e burgut. Një rast ishte nën hetim në fund të vitit.

Vëzhgimi i pavarur: Ligji mundëson që personat në paraburgim të vizitohen nga mjekët, përfaqësuesit diplomatikë dhe përfaqësuesit KPT-së dhe të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, me leje paraprake nga gjykatësi hetues. Qeveria zakonisht ua ka lejuar organizatave të pavarura humanitare, siç është Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vend, qasjen deri te të burgosurit e dënuar me kërkesë të të burgosurve.

Avokati i Popullit i ka vizituar rregullisht burgjet e vendit dhe i ka hetuar pretendimet e besueshme të kushteve problematike, edhe pse në disa raste stafi i Avokatit të Popullit është kthyer nga burgu për shkak se administratorët e burgut ishin me pushime ose në pushim mjekësor. Nënkomiteti i OKB-së për Parandalimin e Torturës vizitoi një gamë të gjerë të objekteve të paraburgimit në prill. Në një njoftim për shtyp në lidhje me vizitën, theksoi mungesën e burimeve të zyrës së Avokatit të Popullit si një mangësi kritike në parandalimin e torturës në institucionet korrektuese.

#### **a. Arrestimi ose paraburgimi arbitrar**

Ligji ndalon arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe parashikon të drejtën e çdo personi për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij në gjykatë dhe qeveria përgjithësisht ka respektuar këto kërkesa.

#### **Roli i policisë dhe aparatit të sigurisë**

Ushtria është përgjegjëse për sigurinë e jashtë dhe Presidenti është komandanti suprem i Armatës. Policia kombëtare ruan sigurinë e brendshme, duke përfshirë edhe migracionin dhe mbrojtjen e kufijve, dhe përgjigjet para Ministrisë së Punëve të Brendshme. Autoritetet civile nuk i kanë tejkuluar mangësitë në mbikëqyrjen e efektivëve të policisë, në veçanti të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) në Ministrinë e Brendshme, e cila, pa autorizim ligjor ka përgjuar mbi 20000 individë gjatë një periudhe shumëvjeçare (shih pjesën 1.f.). Më 12 shtator, Ministri i Brendshëm Oliver Spasovski paraqiti planet për reformimin e DSK-së dhe për përmirësimin e reputacionit dhe profesionalizmit të saj. Reformat e planifikuara përfshijnë një sistem të dizajnuar për të reduktuar mundësitë e abuzimit nga ana e autoriteteve ligjore të përgjimit. Avokati i Popullit ka marrë nëntë ankesa për përdorim të tepërt të forcës gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare. Vëzhguesit ndërkombëtarë, ambasadat dhe OJQ-të lokale e kanë cekur korrupsionin, mungesën e transparencës dhe presionin politik në Ministrinë e Punëve të Brendshme si pengesë për luftimin e krimit, në veçanti krimit të organizuar.

Autoritetet civile mbajnë kontroll efektiv mbi Ushtrinë dhe Ministrinë e Brendshme, dhe qeveria ka mekanizma efektivë për të hetuar dhe dënuar abuzimin. Gjatë vitit, nuk ka pasur raporte për mosndëshkim që përfshijnë forcat e sigurisë.

Grupi i punës i ngarkuar me hetimin e rolit të Ministrisë së Brendshme në sulmin e 27 prillit në parlament ka konstatuar mangësi ligjore dhe operacionale brenda ministrisë që rrjedhin nga ndikimet e pahijshme politike dhe kriminale mbi zyrtarët, duke përfshirë efektivët e policisë. Si përgjigje ndaj zgjedhjes së kryetarit të ri të parlamentit më 27 prill, rreth 200 demonstrues thyen

kordonin policor, hynë në ndërtesën e parlamentit dhe sulmuan gazetarët dhe deputetët. Ministria e Brendshme në hetimin e kryer në lidhje me ngjarjet e 27 prillit arriti në përfundimin se disa punonjës kanë uzurpuar pozitën e tyre zyrtare dhe nuk kanë mbrojtur në mënyrë të duhur deputetët dhe gazetarët. Si rezultat i hetimit, 180 efektivë policie u morën në pyetje, tetë u shkarkuan, 43 u pezulluan dhe 70 procedura disiplinore janë në vijim e sipër.

Përveç hetimit të pretendimeve për keqtrajtim policor, Sektori për Standarde Profesionale i Ministrisë së Brendshme ka realizuar të gjitha hetimet e brendshme mbi pretendimet për forma tjera të sjelljes së keqe të policëve. Sektori, gjatë hetimeve, ka të drejtën e shqiptimit të sanksioneve administrative, siç është suspendimi i përkohshëm nga puna. Sektori nuk mund të ndërmerr masa disiplinore që kërkojnë vendim nga komisioni disiplinor dhe as të shqiptojë sanksione më serioze penale për të cilat nevojitet vendimi i gjykatës. Gjatë gjysmës së parë të vitit, njësia ka nisur masa disiplinore ndaj 175 efektivëve të policisë dhe ka ngritur gjashtë padi penale kundër punonjësve të Ministrisë për vepra penale, duke përfshirë edhe "shpërdorim të pozitës zyrtare", "mashtim", dhe "keqtrajtim gjatë kryerjes së detyrës. "

### **Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të ndaluarve**

Ligji parasheh që gjyqtari të lëshojë urdhër për arrestimin dhe ndalimin të të dyshuarve bazuar në prova, dhe policia në përgjithësi ka ndjekur këtë dispozitë. Ligji parasheh që personi i ndaluar të paraqitet para prokurorit në afat prej 24 orëve pas arrestimit. Gjyqtari i procedurës paragjyqësore, me kërkesë të prokurorit mund të urdhërojë ndalimin e të dyshuarit deri në 72 orë para daljes në gjyq. Në përgjithësi, policia u është përmbajtur këtyre procedurave. Autoritetet në përgjithësi kanë informuar të ndaluarit menjëherë për akuzat kundër tyre. Paraburgimi para ngritjes së padisë mund të zgjasë më së shumti 180 ditë. Pas ngritjes së padisë, periudha maksimale e paraburgimit është dy vite.

Në shumicën e rasteve, gjykata ka respektuar ligjin për procedurat e paraburgimit paragjyqësor. Problematike kanë qenë selektiviteti dhe mungesa e transparencës së gjykatave gjatë vlerësimit të kërkesave për paraburgim para apo gjatë gjykimit. Statistikat e qeverisë treguan se prokurorët kanë kërkuar urdhra të ndalimit në 5 për qind të të gjitha rasteve. Gjykata Penale e Shkupit, ka pranuar 99 për qind të kërkesave për paraburgim të paraqitura nga Prokuroria Publike dhe nga Zyra e Prokurorisë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion. Në të njëjtën kohë, gjykatat kanë refuzuar 89 për qind të kërkesave të ngjashme për paraburgim dhe masave të tjera parandaluese të paraqitura nga Prokuroria Speciale. Janë aprovuar vetëm katër nga 23 kërkesat për paraburgim nga Zyra e Prokurorisë Speciale. Gjatë vitit paraprak, Gjykatat gjithashtu kishin refuzuar kërkesa nga Zyra e Prokurorisë Speciale për masa parandaluese, duke përfshirë arrestin shtëpiak dhe konfiskimin e pasaportës. Në disa raste, refuzimet e gjykatës kanë mundësuar që të dyshuarit e profilin të lartë t'i shmangen ndjekjes penale.

Më 30 qershor, Prokuroria Speciale kërkoi një urdhër për paraburgimi prej 30 ditësh për të pandehurit në rastet "Target" dhe "Kalaja II", Goran Grujevski dhe Nikola Boshkovski. Gjykata Penale e Shkupit e hodhi poshtë kërkesën më 1 qershor. Më 17 qershor, Gjykata e Apelit në Shkup mbështeti urdhrin e paraburgimit në pritje të një vendimi të Gjykatës Supreme. Më 26 korrik, Gjykata Supreme mbështeti vendimin e gjykatës së apelit dhe lëshoi një urdhër arresti ndërkombëtar kundër të dyve, të cilën Ministria e Brendshme e shpërndau përmes kanaleve të Interpolit. Më 19 tetor, policia greke i ndaloi të pandehurit në Selanik për posedim dhe përdorim të pasaportave të rreme bullgare dhe dokumenteve të identifikimit. Më 8 nëntor, Grujevski u gjykua në mungesë në rastin Kalaja II dhe u dënua me 18 muaj burg. Që nga dhjetori, të dy individët po presin ekstradimin.

Gjykatat nganjëherë nuk kanë arritur të japin arsytim të përshtatshëm për zgjatjen, zëvendësimin, ose ndërprerjen e paraburgimit.

Më 12 maj, Gjykata Supreme e ktheu urdhrin e ndalimit të Gjykatës Penale të Shkupit kundër Sead Koçanit, i cili fillimisht ishte kërkuar nga Prokuroria Speciale. Media njoftoi Kryetari i Gjykatës së Lartë Jovo Vangelovski vonoi nënshkrimin dhe transmetimin e urdhrin të paraburgimit në Ministrinë e Brendshme, duke i lejuar të pandehurit të largohej. Koçani, së bashku me tre biznesmenë të tjerë, dyshohej se kishin falsifikuar dokumentet në vitin 2011 për të fituar një tender prej 17 milionë eurosh nga kompania shtetërore e energjisë për të nxjerrë qymyr nga një minierë në afërsi të qytetit të Manastirit.

Ekziston sistemi i dorëzarisë. Ligji i lejon të pandehurit të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tyre, por autoritetet nuk kanë informuar gjithmonë të ndaluarit ashtu siç duhet për të drejtën e tyre dhe nuk kanë lejuar gjithmonë që të konsultohen me një avokat para paraqitjes në gjykatë. Të ndaluarit e varfër kanë të drejtë të kenë avokat në llogari të shtetit, dhe autoritetet në përgjithësi e kanë respektuar këtë kërkesë. Gjyqtarët zakonisht u kanë dhënë leje avokatëve për të vizituar klientët e tyre në paraburgim. Ka pasur raporte sipas të cilave policia ka vazhduar t'i thërrasë të dyshuarit dhe dëshmitarët në stacione policore për "biseda informative" pa i informuar për të drejtat e tyre dhe pa praninë avokatit. Vendi nuk e ka praktikuar paraburgimin pa njoftim. Në disa raste, autoritetet i kanë mbajtur të dyshuarit në arrest shtëpiak.

Arrestimi Arbitrar: Avokati i Popullit mori dy ankesa për arrestim arbitrar dhe një numër i rasteve të profilit të lartë nga vitet e kaluara nuk janë zgjidhur për shkak të shtyrjeve të vazhdueshme të gjykimit.

Më 28 nëntor, Gjykata Penale e Shkupit urdhëroi arrestimin e 36 të dyshuarve për t'u marrë në pyetje në lidhje me hetimet për sulmet e dhunshme në Parlament më 27 prill. Pas marrjes fillestare në pyetje, gjykata urdhëroi paraburgim 30 ditor për 21 individë, duke përfshirë ish-shefin i sigurisë publike dhe deputetë. Për shkak të imunitetit të tyre parlamentar, deputetët u liruan në pritje të një vendimi parlamentar mbi imunitetin. Më 1 dhjetor, Parlamenti e hoqi imunitetin e deputetëve me kërkesën e gjykatës, duke cituar natyrën e krimit të pretenduar; më 5 dhjetor, Gjykata Penale e Shkupit urdhëroi paraburgim 30-ditor për të tre deputetët të VMRO-DPMNE-së dhe arrest shtëpiak për tre të tjerë. Partia e opozitës VMRO-DPMNE i quajti arrestimet politikisht të motivuara dhe mbështetësit e saj protestuan gjatë disa javëve. Më 28 dhjetor, si përgjigje ndaj një peticioni nga 33 deputetë të VMRO-DPMNE-së që kërkonin nga Avokati i Popullit të shprehet nëse janë shkelë të drejtat e deputetëve, Avokati i Popullit njoftoi se policia kishte shkelur të drejtat e imunitetit parlamentar dhe prezumimin e pafajësisë së gjashtë deputetëve. Ai rekomandoi që Ministria e Punëve të Brendshme të hapte një hetim mbi sjelljen e zyrtarëve të përfshirë dhe pyeti nëse gjykata kishte autoritetin të lëshonte një urdhër arresti për individë me imunitet parlamentar pa e hequr paraprakisht imunitetin të tyre. Më 29 dhjetor, Ministri i brendshëm deklaroi, "gjatë arrestimit të deputetëve, policia veproi ligjërisht - me urdhër të lëshuar nga gjykata", duke shtuar se ai i kishte dorëzuar Avokatit të Popullit dokumentacionin përkatës mbi çështjen. Më 27 dhjetor, paraburgimi i deputetëve u zgjat edhe 30 ditë të tjera.

Mundësia e të ndaluarve të kundërshtojnë ligjshmërinë e paraburgimit para gjykatës: Të dyshuarit e arrestuar, avokatët e tyre ose anëtarët e familjes së ngushtë mund t'i parashtrajnë kërkesë gjykatës për të vendosur mbi ligjshmërinë e paraburgimit ose të lirohen me urdhër gjyqësor, si dhe të marrin kompensim për personat e ndaluar në mënyrë të paligjshme

#### **e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik**

Kushtetuta parashikon gjykata "autonome dhe të pavarura", të mbështetura nga Këshilli Gjyqësor i pavarur dhe autonom. Gjyqësori nuk arriti të demonstrojë pavarësinë dhe paanësinë e vet, dhe gjyqtarët iu nënshtruan ndikimit politik dhe korrupsionit. Rezultatet e shumë

veprimeve gjyqësore janë treguar si të paracaktuara, veçanërisht në rastet kur të pandehurit kanë pasur pikëpamje ose kanë ndërmarrë veprime në kundërshtim me Qeverinë. Financimi joadekuat i gjyqësorit ka vazhduar ta pengojë punën dhe efektivitetin e gjykatave. Disa zyrtarë gjyqësorë e kanë akuzuar Qeverinë për shfrytëzimin e fuqisë buxhetore për të ushtruar kontroll mbi gjyqësorin.

Sipas Raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2016, vendin e dytë sipas numrit të ankesave të parashtruara nga qytetarët (577 ose 15 për qind i totalit) deri te Avokati i Popullit kanë qenë në lidhje me gjyqësorin. Që nga shtatori, Avokati i Popullit kishte marrë 363 ankesa në lidhje me sistemin gjyqësor gjatë vitit. Raporti i Avokatit të Popullit ka cekur se qytetarët janë ankuar në lidhje me gjykimet e gjata, paanshmërinë, drejtësinë selektive, dhe presionin i tepërt mbi gjyqtarët. Një shumë e konsiderueshme e buxhetit të gjyqësorit është shpenzuar për dëmshpërblimet për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Raporti thekson se vendimet gjyqësore nganjëherë janë vonuar në mënyrë të konsiderueshme për shkak të mangësive administrative ose për shkak se gjyqtarët kanë tejkaluar afatet e përcaktuara me ligj për dhënien e vendimeve gjyqësore me shkrim.

Në një raport të lëshuar në vitin 2015, Grupi i Lartë i Ekspertëve të Komisionit Evropian ka theksuar 'atmosferë e presionit dhe pasigurisë brenda gjyqësorit. Shumë gjyqtarë besojnë se avancimi në radhët e gjyqësorit është rezervuar për ata që me vendimet e tyre favorizojnë establishmentin politik'. Përditësimi në këtë raport, i lëshuar më 14 shtator, vuri në dukje se në kuadër të gjyqësorit "shumë prej praktikave të denoncuar në raportin e vitit 2015 kanë vazhduar". Raporti në mënyrë specifike pohon se "Kontrolli dhe keqpërdorimi i sistemit gjyqësor ... për të shërbyer dhe promovuar interesat politike nuk është zvogëluar në ndonjë masë të konsiderueshme".

Ndërsa ka pasur rregulla të rrepta që e rregullojnë shpërndarjen e lëndëve, të realizuara nëpërmjet një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve, Grupi i Lartë i Ekspertëve të Komisionit Evropian në raportin ka vënë në dukje se "ka shenja të besueshme se janë bërë ndërhyrje të shpeshta në këtë sistem me qëllim që të sigurohej që rastet e ndjeshme t'u ndahen gjyqtarëve të caktuar". Në Raportin vjetor të progresit të vitit 2016, Komisioni Evropian konstaton se akuzat për ndërhyrje të drejtpërdrejtë nga autoritetet gjyqësore në përdorimin e sistemit informatikë të menaxhimit të rasteve (ACCMIS) për të caktuar gjyqtarë për t'u marrë me procedura specifike të iniciuara nga Prokuroria Speciale. Gjetjet fillestare të auditimit qeveritar të sistemit ACCMIS që u lëshuan më 7 dhjetor, zbuluan se sistemi ishte manipuluar, duke vërtetuar zërat e kamotshëm për abuzime. Ministria e Drejtësisë tha se do t'i paraqiste rezultatet e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorit Publik për veprim.

Më 20 shkurt, kryetari i Gjykatës Penale të Shkupit, Tatjana Mihajlova, transferoi 20 (nga gjithsej 67) gjyqtarë që kryesonin lëndë penale të nivelit të lartë në departamentet të gjykatës për kundërvajtje dhe të mitur. Anëtarë të shumtë të gjyqësisë pretenduan se transferimet ishin si hakmarrje për vendimet në favor të Prokurorisë Speciale. Gjyqtarët gjithashtu kanë pretenduar se Mihajlova dhe pasardhësi i saj, Stojançe Ribarev, i kanë caktuar vetëm gjyqtarët që deri atëherë kishin penguar Prokuroren Speciale të ndjek rastet e ngritura nga Zyra e Prokurores Speciale.

Në Raportin e vitit 2015 të Grupit të Ekspertëve të Lartë të Komisionit Evropian janë ngritur shqetësime në lidhje me drejtësinë e dënimit të Zvonko Kostovskit, i pandehur në rastin e ashtuquajtur "grusht-shteti". Kostovski, një oficer i kundërzbulimit në Ministrinë e Brendshme, është shpallur fajtor për spiunazh dhe përgjim të paligjshëm të komunikimeve dhe është dënuar me tre vjet burg. Kostovski ka pohuar se ai kishte bërë përgjime të bisedave kompromituese për kreun e partisë opozitare LSDM-së Zoran Zaev në mënyrë që ai të shantazhojë ish kryeministrin Nikolla Gruevski dhe ta detyrojë atë që ta fuste LSDM-në në Qeveri. Në raportin e tij, Grupi i Lartë i Ekspertëve ka shprehur shqetësimin se ka qenë e pamundur të dihet se në çfarë mase

faktet kanë mbështetur pranimin e fajësisë dhe nëse dënimi i lehtë ka qenë një shpërblim për pjesëmarrje në fshehjen e përfshirjes së të tjerëve. Në tetor të vitit 2016, Prokuroria Speciale ka kërkuar një rishikim të jashtëzakonshëm nga ana e Gjykatës Supreme në lidhje me ujdinë e Kostovskit. Më 12 korrik, Prokurorja speciale mori kopjen origjinale të marrëveshjes së pranimit të fajësisë së Kotovskit dhe e apeloj padinë në Gjykatën Supreme duke përmendur shkeljet substanciale procedurale. Që nga 1 dhjetori, shqyrtimi i Gjykatës Supreme ishte në pritje.

## **Procedurat gjyqësore**

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë të drejtën për një gjykim të drejtë, edhe pse ndërhyrjet politike në punën dhe emërimin e gjyqësorit shpesh e kanë shkelur këtë të drejtë.

Në vitin 2015, një ligj hyri në fuqi i cili përmban udhëzime të përditësuara të dënimeve të projektuara për të trajtuar dënime në kundërshtim me gjykata të niveleve të ndryshme. Analistët ligjorë janë shprehur të shqetësuar se ligji pengon seriozisht diskrecionin gjyqësor për të vendosur dënime në bazë të fakteve në rastet individuale, ndërkaq prokurorëve u ka dhënë shumë fuqi për të ndikuar në dënimin.

Ligji e parashih prezumimin e pafajësisë, deri në momentin kur dëshmohet fajësia e të pandehurve. Të pandehurit kanë të drejtë të informohen menjëherë dhe hollësisht për akuzat (me interpretim falas sipas nevojës), por autoritetet nuk e kanë respektuar gjithmonë këtë të drejtë. Në përgjithësi, gjykimet kanë qenë të hapura për publikun. Gjykimet e profilit të lartë u zhvilluan me vonesa të shpeshta. Avokati i Popullit ka përmendur procedurat gjyqësore të vonuara si shkelje të të drejtave të qytetarëve dhe vuri në dukje numrin e ankesave lidhur me procedurat gjyqësore të vonuara të ngritura gjatë vitit, krahasuar me vitin 2016.

Avokatët mbrojtës dhe aktivistë të të drejtave të njeriut kanë pretenduar se mbyllja e disa gjykimeve të profilit të lartë për publikun e kanë zvogëluar transparencën dhe kanë kontribuar në zvogëlimin e besimit të publikut në gjykatat, veçanërisht në mesin e popullatës shqiptare. Mbrojtja në gjykimin e rastit “Monstra” dhe gjykimi i rastit të Kumanovës, procedurat e të cilave në masë më të madhe u mbajtën me dyer të mbyllura, në mënyrë të përsëritur ka ngritur shqetësime të tilla.

Për disa raste penale dhe civile, janë përdorur panele gjyqësore prej tre deri pesë individë, të udhëhequr nga një gjyqtar profesionist. Autoritetet nuk i kanë dhënë gjithmonë të pandehurit kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtje. Të pandehurit mund t’u bëjnë pyetje dëshmitarëve dhe të paraqesin prova në emër të vet. Autoritetet nuk mund të detyrojnë të pandehurit të dëshmojnë ose të pranojnë fajësinë. Si prokuroria ashtu dhe të pandehurit kanë të drejtën të parashtrajnë ankesa ndaj aktgjykimeve.

## **Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë**

Më 14 korrik, gazetari Zoran Bozhinovski u lirua nga paraburgimi pas 15 muajsh. Në prill të vitit 2016 autoritetet serbe miratuan ekstradimin e tij në Maqedoni në bazë të një urdhër-arresti të Interpolit duke e akuzuar atë për organizim kriminal, spiunazh, dhe zhvatje, si dhe se ai ka qenë pjesë e një rrjeti spiunazhi që ka punuar për qeveri të huaja. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë e kishte quajtur arrestimin dhe ndalimin e Bozhinovskit "politikisht të motivuar dhe se kishte për qëllim heshtjen e gazetarëve që kishin guximin të bënin publike skandalet për autoritetet".

Bozhinovski thuhet se ishte zhvendosur në Serbi për shkak të shqetësimit për sigurinë e tij, pas postimit të artikujve me kritika ndaj Qeverisë së mëparshme, partisë VMRO-DPMNE, dhe ish-kryeministrit Gruevski.

## **Procedurat dhe mjetet juridike civile**



Qytetarët kanë pasur qasje në gjykata për ngritjen e procedurave me të cilat kërkohet dëmshpërblim për shkeljen e të drejtave të njeriut. Individët mund të iniciojnë procedura për të drejtat e njeriut në gjykatat civile, penale ose administrative, dhe në Gjykatën Kushtetuese, varësisht nga lloji i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe nga kryerësi i pretenduar. Individët mund të parashtrajnë edhe ankesa ndaj aktgjykimeve të pavolitshme. Ligji e parasheh të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm dhe kjo është bazë ligjore për ngritjen e procedurave kundër vonesave të tepërta para Gjykatës Supreme. Në përgjithësi, Qeveria i ka respektuar aktgjykimet civile të gjykatave vendase. Individët mund të ankohen për rastet që përfshijnë shkeljet e pretenduara nga shteti të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), pasi të jenë shterur të gjitha mundësitë e brendshme ligjore.

Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2016, vuri në dukje problemet e vazhdueshme në lidhje me të drejtën e gjykimit në një kohë të arsyeshme. Sipas raportit, raste të zvarritura gjyqësore civile dhe administrative, si dhe praktikat e pamjaftueshme të zbatimit civil, kanë rezultuar me shkelje të të drejtave të qytetarëve.

### **Kthimi i pronës**

Mundësia për të aplikuar për kthimin e pronës së konfiskuar gjatë Holokaustit është e kufizuar për shtetasit maqedonas. Kthimi i pronës nga periudha e Holokaustit nuk është më një çështje domethënëse në vend, veçanërisht pas Ligjit të Denacionalizimit të vitit 2000 dhe marrëveshjes së kompensimit të vitit 2007.

Ligji për Denacionalizim i vitit 2000 i akordoi të drejtën e denacionalizimit të pasurisë së konfiskuar pas gushtit të vitit 1944 ish-pronarëve dhe pasardhësve të tyre, në përputhje me dispozitat lidhur me të drejtën e trashëgimit. Ai kërkon që aplikuesit të kenë shtetësinë maqedonase në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit.

Marrëveshja e kompensimit për vitin 2007 ishte midis Qeverisë, Fondit të Holokaustit dhe Bashkësisë Hebraike dhe mundësoi pagesën prej 21.1 milionë eurosh (25 milionë dollarë) midis qershorit 2009 dhe qershorit 2018. Deri më tani janë paguar 15.6 milionë euro (18.7 milionë dollarë). Një nga rezultatet e saj kryesore ishte ndërtimi i Qendrës Përkujtimore të Holokaustit të Hebrenjve nga Maqedonia, e cila zyrtarisht u hap në vitin 2011.

Qeveria nuk ka ligje apo mekanizma në lidhje me zgjidhjen e kërkesave të kohës së Holokaustit nga shtetasit e huaj

### **f. Ndërhyrje arbitrare në privatësi, familje, shtëpi ose korrespondencë**

Ligji i ndalon këto veprime, megjithëse ka raporte që tregojnë se Qeveria nuk i ka respektuar këto ndalime gjatë vitit.

Qeveria ka vazhduar të merret me pasojat e zbulimit të përgjimeve të paligjshme, për të cilat pretendohet se janë kryer vite të tëra brenda ambienteve të DSK-së. Kjo fushatë për herë të parë u raportua nga partia e LSDM-së në atë kohë opozitare, në shkurt të vitit 2015. Në raportin e 14 shtatorit, Grupi i Ekspertëve të Lartë të Komisionit Evropian deklaroi, "Masat urgjente për të parandaluar përgjimin e paligjshëm nuk janë adresuar" dhe vuri në dukje se përgjimet e paligjshme mund të kenë vazhduar pas qershorit të vitit 2015. Sipas raportit, DSK ende mban një monopol përgjimi të komunikimeve për qëllime të sigurisë dhe hetimeve penale, të cilat ndërhyjnë në autonominë e forcave të policisë. Raporti gjithashtu vë në dukje shqetësimet e mbetura lidhur me mungesën e respektit për të drejtat themelore të njeriut dhe rregullat e

mbrojtjes së të dhënave brenda DSK-së. Më 31 tetor, qeveria ngriti një grup pune ekspertësh për të reformuar sistemin e përgjimit ligjor, të kryesuar nga zëvendës drejtori i DSK-së, Siljan Avramovski.

Grupi i Ekspertëve të Lartë të Komisionit Evropian ka kritikuar Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, agjencia përgjegjëse për mbikëqyrjen e trajtimit të të dhënave personale nga Qeveria, për "mungesën evidente të mbrojtjes së të dhënave, regjistrimit të mundshëm e të palejueshëm dhe të pakontrolluar të numrave të telefonit, si dhe privimin nga e drejta e privatësisë nëpërmjet ndjekjes potencialisht të paautorizuar."

Në fund të vitit 2016, drejtorja ka kryer katër inspektime të DSK-së dhe ka filluar një inspektim kontrolli më 24 korrik për të matur zbatimin e 11 rekomandimeve të bëra gjatë inspektimeve të vitit 2016. Një raport i pajtueshmërisë i publikuar nga Drejtorja më 24 nëntor thotë se Ministria e Punëve të Brendshme u pajtua plotësisht me 10 rekomandime dhe pjesërisht me një rekomandim.

Në maj të vitit 2016, koalicioni qeveritar, nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, ka miratuar ndryshimet në Ligjin për mbrojtjen e privatësisë të cilat e ndalojnë posedimin, përpunimin dhe publikimin e çdo përmbajtje, duke përfshirë bisedat e përgjuara, me ç'rast shkelet e drejta e privatësisë në lidhje me jetën personale apo familjare. Amendamentet, që hynë në fuqi në korrik, gjithashtu e ndalojnë përdorimin e materialeve të tilla në fushatat zgjedhore apo për qëllime të tjera politike.

Lustrimi – procesi i identifikimit publik të individëve të cilët kanë bashkëpunuar me shërbimet e fshehta gjatë periudhës së komunizmit, si dhe ndalimit të tyre nga ushtrimi i detyrave zyrtare dhe përfitimeve tjera qeveritare u ndërpre gjatë vitit. Më 29 gusht, një raport mbi aktivitetet e Komisionit të Lustrimit nga viti 2009 deri në vitin 2017 u paraqit në parlament. Më 13 shtator, parlamenti i dha fund komisionit pa debat. GJEDNJ ka vendosur dy herë, më së fundi në prill, se procedurat e lustrimit në vend kanë shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## **Pjesa 2. Respektimi i lirive civile, ku përfshihet:**

### **a. Liria e shprehjes, duke përfshirë edhe të shtypit**

Kushtetuta e garanton lirinë e fjalës, duke përfshirë edhe të shtypit, por presioni qeveritar mbi medien, mosndëshkimi i autorëve të dhunës ndaj gazetarëve dhe anëtarëve të tjerë të medias, dhe një treg mediatik i ndarë përgjatë linjave partiake, ka vazhduar të paraqes një problem. Organizata ndërkombëtare e të drejtave të njeriut Freedom House e karakterizoi peizazhin mediatik si "jo të lirë" për vitin e dytë me radhë. Një studim i Fondacionit Metamorfozis 2016-17, i publikuar më 10 gusht, zbuloi se vetëm 5 për qind e shtetasve kanë pohuar se i besonin plotësisht medias."

Më 28 prill, gjashtë organizata mediatike, duke përfshirë Qendrën Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe të Medias dhe Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), publikuan një deklaratë ku shprehën shqetësi rreth rritjes së dhunës ndaj gazetarëve. Anëtarët e komunitetit të medias kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë SHGM-në dhe Federatën Evropiane të Gazetarëve, akuzuan qeverinë e mëparshme se nuk respektojnë lirinë e fjalës dhe shtypin dhe nuk marrin përgjegjësi për mbrojtjen e gazetarëve.

Liria e shprehjes: Ligji e ndalon gjuhën e cila nxit urrejtje nacionale, fetare ose etnike dhe parasheh sanksione për personat që i shkelin këto ligje. Individët mund ta kritikojnë Qeverinë publikisht ose privatisht. Megjithëse pjesa më e madhe e reklamave Qeveritare u pezulluan në vitin 2015, ka pasur raportime sipas të cilave qeveria e mëparshme ka tentuar ta pengojë kritikën në media gjatë vitit, përmes orientimit të porosive të reklamave drejt medieëve pro-qeveritare para formimit të qeverisë së re në maj.

Liria e mediave dhe shtypit: Një numër i kufizuar i medieve të pavarura kanë qenë aktive dhe kanë shprehur vështrime të ndryshme pa kufizim. Mediet dhe raportimi ka mbetur i ndarë përgjatë linjave politike. Ligjet që ndalojnë gjuhën e cila nxit urrejtjen nacionale, fetare dhe etnike mbulojnë edhe shtypin dhe mediat elektronike, publikimin e librave, si dhe gazetat dhe revistat në internet.

Freedom House raportoi më 2 shkurt, "Shumë shtëpi mediatike private janë në pronësi të biznesmenëve, të cilët kanë përdorur shtëpitë e tyre si mjet për të promovuar interesat komerciale ose për të favorizuar qeverinë." Sipas edicionit të prillit të SHGM-së *Përmbledhje e Situatës së Mediave në Maqedoni* të SHGM-së, ku jepet vlerësimi i peizazhit mediatik para formimit të qeverisë së re, si autoritetet qendrore ashtu edhe ato lokale kanë shpenzuar fonde publike në media. Raportohet se Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës të ketë shpenzuar shumë më të madhe, kryesisht për të subvencionuar stacionet televizive kombëtare për të prodhuar programe lokale.

Nga se Qeveria tradicionalisht ka qenë njëra nga blerësit më të mëdhenj të reklamave në shtet, shumë nga mediat kanë mbetur financiarisht të varura nga mjetet e Qeverisë dhe prandaj kanë qenë objekt presioni për të mos e kritikuar të njëjtën. Në Raport progresin për zgjerim të vitit 2015, Komisioni Evropian ka vënë në dukje se reklamat qeveritare kanë qenë burimi më i madh i vetëm i fondeve për mediat dhe ka pasur një ndikim të madh në tregun e mediave në nivel nacional dhe lokal. Ka pasur raporte të besueshme se qeveria e mëparshme e ka shpërdorur fuqinë e saj të tregut për të ndikuar në përmbajtjen e medias.

Më 22 gusht, qeveria ndërpreu të gjitha reklamat e paguara nga qeveria në mediat komerciale, duke përfshirë mediat elektronike, të shtypura, billboardet dhe portalet e internetit, me përjashtim të mediave sociale. Kjo politikë u bë e detyrueshme për të gjitha agjencitë shtetërore dhe u inkurajua edhe për pushtetin lokal.

Më 19 shtator, Parlamenti shfuqizoi tarifën mujore të transmetimit publik prej 190 denarëve (katër dollarë) të paguara nga çdo familje. Tarifa është përdorur për të ndihmuar në financimin e transmetuesit publik, Radio Televizionin e Maqedonisë (MRTV). Sipas ligjit të ri, MRTV do të marrë fonde direkte që arrijnë në 0.5 për qind të buxhetit vjetor të shtetit.

Raporti i 14 shtatorit të Grupit të Ekspertëve të Lartë të Komisionit Evropian, vëren se gazetarët shpesh dështuan të përmbushin standardet etike. Grupi gjithashtu raportoi se ka pasur pretendime për vetë-censurim dhe raportim selektiv midis disa gazetarëve, të cilat kanë qenë rezultat i praktikave korruptive dhe mungesës së aftësive të nevojshme profesionale. Ekspertët mediatikë kanë raportuar se frikësimi, mungesa e kushteve të mira të punës për gazetarët dhe mungesa e qëndrueshmërisë financiare e kompanive të medias i ka lënë pa mbrojtje nga presioni i Qeverisë dhe në varësi të reklamave të Qeverisë.

Raporti përfundimtar i misionit vëzhgues të OSBE-së për zgjedhjet e dhjetorit 2016 vuri në dukje shqetësimet në lidhje me pavarësinë e transmetuesit publik MRTV dhe Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, kërcënimet ndaj gazetarëve dhe dështimit të mediave për të siguruar mbulim të balancuar dhe të paanshëm gjatë zgjedhjeve.

Duke filluar nga data 7 gusht, Agjencia për Media Audio dhe Audiovizuale publikoi raporte për mbulimin mediatik të zgjedhjeve lokale të tetorit çdo 10 ditë gjatë periudhës së fushatës. Në një raport të 15 dhjetorit që përmbledh gjetjet e tij, Agjencia pohoi se shtatë stacione kanë bërë 14 shkelje të kodit zgjedhor, duke përfshirë tejkalimin e kohës së lejueshme për reklamat politike të paguara, transmetimin e një sondazhi pa dhënë burimin, dhe mossigurimi i mbulimit të balancuar në emisionet e lajmeve ditore.

Dhuna dhe ngacmimi: Disa gazetarë kanë raportuar kërcënime dhe frikësime kundër tyre, duke përfshirë edhe zyrtarë qeveritarë.

Në qershor SHGM publikoi një raport, *Rastet e shkeljeve të të drejtave të gazetarëve dhe reagimet e institucioneve në Maqedoni*. Në raport janë dokumentuar 14 incidente të sjelljes së dhunshme ndaj gazetarëve ose dëme ndaj pronave të tyre që nga fillimi i vitit.

Më 7 qershor, individë të paidentifikuar kërcënuan kryeredaktoren e një faqeje interneti të lajmeve në gjuhën shqipe, Elida Zylbeari, pasi ajo kishte botuar një artikull mbi shpërdorimin e pretenduar nga Blerim Bexheti gjatë kohës së tij si kryetar i komunës së Sarajit. Hetimi mbi rastin nuk kishte përfunduar në shtator. SHGM ka deklaruar se sulmi dhe ngacmimi ndaj Zylbearit dëshmonte për një mjedis në të cilin agresioni përdoret për të heshtur gazetarët.

Sipas SHGM-së dhe OJQ -së Civicus, kërcënimet e vazhdueshme ndaj kritikëve të ish partisë qeverisëse, VMRO-DPMNE, janë raportuar gjatë vitit. Më 16 qershor, gazetari Branko Triçkovski mori një kërcënim me vdekje në internet nga aktori Toni Mihajlovski. Triçkovski më parë ka vuajtur nga ngacmimet dhe kërcënimet nga aktivistë të lidhur me ish-partinë në pushtet dhe pretendohet se individë të afërt me ish-partinë në pushtet i janë afruar në shtëpinë e tij në mars.

Përveç akteve të dhunës dhe ngacmimit, ka pasur njoftime të besueshme se gazetarët kanë hasur në pengesa të tjera gjatë përpjekjeve për të informuar publikun me lajmet e fundit. Për shembull, 21 gazetarë u kërcënuan ose iu ndalua të raportonin dhe gjashtë gazetarë u rrahën ndërsa mbulonin një deontratë që më vonë rezultoi me hyrjen me forcë në godinën e parlamentit më 27 prill. Dimitar Tanurov, një gazetar për agjencinë e pavarur të lajmeve Meta, i tha Komitetit për Mbrojtje të Gazetarëve që protestuesit e zemëruar e kishin kërcënuar dhe e kishin udhëzuar atë të mos fotografonte gjatë demonstratës së 27 prillit në Parlament. Sipas Tanurov, "kur panë kartën time të shtypit dhe shtëpinë për të cilën punoja, ata më quajtën tradhtar, morën telefonin tim dhe vazhduan të më rrihnin dhe të më godasin ndërsa isha shtrirë në dyshemë".

Më 27 shkurt dhe 10 mars, autorë të panjohur sulmuan gazetarët që raportonin nga protestat "Për një Maqedoni të Bashkuar".

Grupet e mbikëqyrësve të medias deklaruan se autoritetet nuk i kanë hetuar, akuzuar apo dënuar autorët e dhunës kundër gazetarëve siç duhet. Kjo ka krijuar një mjedis të përgjithshëm të mosndëshkimit.

Censura ose kufizimi i përmbajtjeve: Ka pasur raportime sipas të cilave Qeveria ka detyruar gazetarët të vetë-censurohen. Gazetarët kanë raportuar për ndërhyrje shumë më të madhe gjatë raportimit për çështjet e ndjeshme për Qeverinë. Mediet në pronësi private kanë pohuar që kanë marrë thirrje të rregullta telefonike nga nivelet më të larta qeveritare, për t'i udhëzuar si dhe çka duhet të raportohet për çështjet politike.

Ligjet për shpifje/Siguria nacionale: Personat e shpallur fajtorë për trillime, shpifje dhe gjuhë të ligë janë dënuar sipas gjobave të përcaktuara për shkaktimin e dëmit jomaterial. Disa redaktorë dhe pronarë të medieve e kanë shprehur shqetësimin e tyre se gjobat e larta do të shkaktojnë vetë-censurë. Ka pasur raporte për atë se Qeveria e mëparshme e ka shfrytëzuar ligjin si vegël për të goditur e kundërshtarët politikë.

Sipas SHGM, deri më 23 nëntor, ka pasur rreth 39 raste për shpifje që përfshijnë gazetarët, redaktorët, dhe/ose menaxherët dhe pronarët e medias, në pritje të gjykimit. Informacioni në lidhje me rastet në pritje nga vitet e kaluara nuk ishte i plotë.

## **Liria e internetit**

Qeveria nuk ka kufizuar ose penguar qasjen në internet ose censuruar përmbajtjet në internet. Nuk ka pasur raporte të besueshme për vëzhgim qeveritar të komunikimeve private online pa autorizim përkatës ligjor. Në vazhden e skandalit me përgjimet në vitin 2015, megjithatë, ka mbizotëruar ndjenjë e gjerë në publik se Qeveria rregullisht e ka ndjekur internetin. Kjo ndjenjë ka bërë që shumë qytetarë të përdorin aplikacionet e mesazheve që ofronin kriptim të komunikacionit, siç janë Viber, WhatsApp, Facebook Messenger, dhe Telegram. Enti Shtetëror i Statistikës ka vlerësuar se 75 për qind e popullsisë ka përdorur internetin në tremujorin e parë të vitit, në krahasim me 69 për qind në 2016.

## **Liria akademike dhe ngjarjet kulturore**

Nuk ka pasur kufizime qeveritare për lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

### **b. Liria e tubimit paqësor dhe shoqërimit**

#### **Liria e tubimit paqësor**

Ligji e parasheh lirinë e tubimit paqësor dhe Qeveria në përgjithësi i ka respektuar atë.

Më 28 korrik, policia arrestoi katër anëtarë të partisë politike Levica ndërsa protestuan për një ngjarje publike në Shkup pas një stërvitjeje të përbashkët ushtarake që përfshinte forca të huaja. OJQ Civil lëshoi një video të incidentit ku paraqitej një efektiv policie që lëshonte një urdhër për grupin për t'u shpërndarë dhe pastaj për të arrestuar një anëtar të partisë pasi grupi shpalosi një flamur në të cilin shkruante "Kundër luftës për profit". Ministria e Brendshme raportoi se individët u ndaluan shkurtimisht në vendngjarje dhe më pas u liruan pa akuza. Një hetim nga Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Njësia e Standardeve Profesionale vazhdonte në fund të vitit.

### **b. Liria e shoqërimit**

Ligji e parasheh lirinë e shoqërimit, dhe Qeveria në përgjithësi e ka respektuar atë.

### **c. Liria e besimit fetar**

Shikoni *Raportin e Departamentit të Shtetit mbi liritë fetare ndërkombëtare* në [www.state.gov/j/drl/irf/rpt](http://www.state.gov/j/drl/irf/rpt)

### **d. Liria e lëvizjes**

Qeveria ka bashkëpunuar me Zyrën e Komisionarit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR), Organizatën Ndërkombëtare për Migracion, dhe organizata të tjera humanitare duke ofruar mbrojtje dhe ndihmë për personat e zhvendosur brenda vendit (PZHB), refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit, migrantët, personat pa shtetësi, dhe persona të tjerë në nevojë.

Abuzimi i migrantëve, refugjatëve dhe personave pa shtetësi: Sipas Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, që nga shtatori, 38 emigrantë u strehuan në qendrat e transitit të vendosura në pikat kufitare veriore dhe jugore me Serbinë dhe Greqinë. Në një raport të prillit, Shoqata e Avokatëve të Rinj të Maqedonisë ka vlerësuar se 350 emigrantë janë të zhvendosur në vend dhe se 200 nuk ishin vendosur në ambiente të menaxhuara nga autoritetet qeveritare.

Gjatë vitit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka regjistruar 11 krime të urrejtjes kundër emigrantëve, që përfshijnë rrahje, torturë dhe grabitje. Komiteti gjithashtu vuri në dukje se, në përgjigje të thirrjeve për referendume lokale për vendosjen e emigrantëve, "Debati publik u pasua nga një volum i lartë i gjuhës së urrejtjes ksenofobe ndaj refugjatëve, duke i identifikuar ato me terroristët, duke bërë thirrje për parandalimin e vendosjes së tyre në vend me mesazhe fyese dhe poshtëruese. Janë ngritur disa iniciativa qytetare që synojnë grumbullimin e firmave të shtetasve kundër emigrantëve, të cilët vazhdimisht kanë inkurajuar dhe provokuar gjuhën e urrejtjes".

Udhëtimi jashtë vendit: Kushtetuta lejon lëvizjen e lirë dhe Qeveria mund ta kufizojë vetëm kur është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare, hetimet penale, ose shëndetin publik.

Gjatë vitit, Avokati i Popullit dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut kanë pranuar disa ankesa, sidomos nga individë të përkatësisë rome, se autoritetet shtetërore iu kishin mohuar lirinë e lëvizjes vetëm bazuar në profilin e tyre etnik, racor, dhe / ose fetar, edhe pse numri i ankesave ka qenë më i ulët se vitet e mëparshme.

Më 11 shtator, Gjykata Themelore Shkup II solli vendimin se Ministria e Brendshme kishte shkelur të drejtat e dy familjeve rome për trajtim të barabartë duke imponuar një kufizim udhëtimi në kartat e tyre të identitetit kombëtar. Gjykata dënoi të pandehurit me 200,000 denarë (\$ 3.800) për dëmet.

### **Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)**

Qeveria ka raportuar për 183 persona të zhvendosur, që kanë mbetur në këtë pozitë që nga konflikti i brendshëm i vitit 2001. Prej tyre, 27 kanë jetuar në qendra kolektive, kurse 156 kanë qenë të vendosur në familje mikpritëse.

### **Mbrojtja e refugjatëve**

Qasja ndaj azilit: Ligjet e vendit e parashohin dhënien e azilit ose statusit të refugjatit, ndërkaq Qeveria ka krijuar sistem për dhënien e mbrojtjes për refugjatët. UNHCR ka raportuar se mekanizmi për përcaktimin e statusit të refugjatëve nuk ka siguruar garanci themelore procedurale dhe përcaktim adekuat, siç parashihet me ligj. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka vlerësuar se 69 migrantë kanë aplikuar për azil në nëntë muajt e parë të vitit. Megjithatë, janë raportuar raste të shumta të individëve të cilëve nuk u është lejuar të paraqesin një kërkesë për azil, madje edhe pasi kanë deklaruar shprehimisht qëllimin e tyre për ta bërë këtë. Që nga 7 shtatori, 19 kërkesa për azil ishin në përpunim, zero migrantë kishin marrë azil, dhe katër u është dhënë mbrojtje subsidiare. Qeveria ka vazhduar me refuzimin e aplikacioneve për azil, kryesisht me arsyetimin se aplikuesit e kanë rrezikuar sigurinë nacionale.

Raportohet se azilkërkuesve nga vendet e tjera me konflikte aktive, si Libia dhe Jemeni, u është mohuar hyrja. UNHCR ka deklaruar se këto "shtyrje mbrapa" paraqesin shkelje të Konventës së Refugjatëve të vitit 1951, si dhe Protokollin 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qeveria u ka lëshuar dokumente të identifikimit të gjithë refugjatëve të njohur dhe personave tjerë nën mbrojtje subsidiare, por autoritetet shesh kanë vonuar ose nuk ua kanë lëshuar dokumentet e identifikimit azilkërkuesve të rinj.

Vendi i sigurt i origjinës / transitit: Ligji përmban një përkufizim të gjerë të "vendit të tretë të sigurt" që përfshin çdo shtet anëtar të BE-së, NATO-s ose Zonës së Tregtisë së Lirë të Evropës, me çka në mënyrë efektive përjashton çdo hyrje të migrantëve në vend me vijë tokësore nga vendet e tjera me përjashtim të Kosovës dhe Serbisë për të kërkuar azil.

Zgjidhjet e qëndrueshme: Në muajin tetor, 98 individë nga konflikti i vitit 1999 në Kosovë ishin kthyer në Kosovë. UNHCR edhe më tej i ka ndihmuar azilkërkuessit nga Kosova të cilët janë refuzuar dhe që u është lejuar të qëndrojnë në vend. Qeveria u ka lëshuar atyre dokumente të përkohshme identifikimi, për tua siguruar qasjen deri te shërbimet. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka siguruar zgjidhje të integruara dhe të qëndrueshme, me mbështetjen e UNHCR-së për rreth 530 refugjatë që kanë aplikuar për integrim në vend.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria siguron mbrojtjen shitesë për individët të cilët nuk mund të kualifikohen si refugjatë, dhe ia ka dhënë atë 377 personave gjatë vitit deri në nëntor.

### **Personat pa shtetësi**

Disa banorë të përhershëm ishin ligjërisht pa shtetësi, pavarësisht përmbushjes së një ose më shumë kriterëve për shtetësi. Deri në Korrik 2016, UNHCR ka raportuar 641 persona në vend nën mandatin e saj për personat pa shtetësi, kryesisht romë, të cilët nuk kanë qenë të regjistruar dhe pa dokumente të identifikimit. Fëmijët e lindur në vend të personave pa shtetësi konsiderohen shtetas dhe kanë të drejtën të regjistrohen dhe të marrin certifikatë.

### **Seksioni 3. Liria për të marrë pjesë në procesin politik**

Ligji iu ofron qytetarëve mundësinë për të zgjedhur qeverinë e tyre në zgjedhje periodike të lira dhe të drejta të mbajtura me votim të fshehtë dhe në bazë të votimit të përgjithshëm dhe të barabartë. Zgjedhjet lokale u mbajtën më 15 tetor, me një raund të dytë më 29 tetor. Sipas raportit paraprak të OSBE / ODIHR, zgjedhjet u zhvilluan në një mjedis konkurrues, duke u respektuar liritë themelore të votuesve dhe zgjedhjet "kontribuan në forcimin e besimit në proceset demokratike". Problemet e vërejtura gjatë periudhës parazgjedhore përfshinin akuza të besueshme për blerjen e votave, presion mbi votuesit dhe raste të izoluara të dhunës. OSBE / ODIHR konstatoi se përkundër sfidave organizative, dita e zgjedhjeve përgjithësisht rrodhi në mënyrë të rregullt.

### **Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike**

Zgjedhjet e fundit: Zgjedhjet parlamentare të viti 2016 kanë shënuar një rekord pjesëmarrje të lartë dhe janë konstatuar vetëm parregullsi të vogla. Sipas raportit të OSBE / ODIHR-it, edhe pse Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka hasur në vështirësi gjatë përgatitjes për zgjedhjet, dita e zgjedhjeve përgjithësisht është administruar mirë dhe me rregull. Ndërsa ODIHR ka konstatuar se liritë themelore janë respektuar në përgjithësi, dhe kandidatët kanë qenë në gjendje të zhvillojnë lirshëm fushatën, ka vënë në dukje se zgjedhjet janë zhvilluar "në një mjedis të karakterizuar nga mungesa e besimit publik në institucionet dhe establishmentin politik, dhe pretendime për detyrimin e votuesve." Sipas ODIHR, zgjedhjet nuk kanë arritur të përmbushin disa angazhime të rëndësishme të OSBE-së për një proces zgjedhor demokratik, duke përfshirë frikësimin e votuesve, presion i përhapur mbi punonjësit publikë, blerjen e votave, detyrimin, dhe shpërdorimin e burimeve administrative.

Partitë politike dhe pjesëmarrja politike: Ka disa kufizime në themelimin ose anëtarësimin në partitë politike, të cilat i nënshtrohen ligjeve të njëjta si çdo qytetar i zakonshëm. Ndërsa anëtarësimi në një parti politike nuk është i detyrueshëm, ka një sistem aktiv patronazhi në vend ku palët japin përfitime dhe avantazhe të veçanta për anëtarët e tyre. Partia opozitare VMRO-DPMNE akuzoi qeverinë për vazhdimin e këtyre praktikave, duke pretenduar se nuk janë ndjekur kualifikimet arsimore dhe profesionale të përcaktuara me ligj për pozitat e administratës. Më 6 korrik, Spase Gligorov u emërua udhëheqës i Agjencisë për Administratë pas dorëheqjes së

tij nga Komiteti Ekzekutiv i LSDM-së. Emërimi i Ivan Barbov si drejtor i Klinikës Universitare të Neurologjisë në Shkup gjithashtu konsiderohej e diskutueshme. Barbov ishte dënuar me kusht në vitin 2012 për pjesëmarrje në një grup që u akuzua për marrje parash nga pacientët për lëshimin e dokumenteve të paligjshme të sigurimit me të cilat ata fitonin pension invalidor. Burime të shumëfishta, megjithatë pretendonin se disa të pandehur në këtë rast ishin subjekt i ndjekjeve të motivuara politikisht nga qeveria e mëparshme VMRO-DPMNE. Analistët Ligjorë vunë në dukje se në disa raste të profilit të lartë, nëse kishte rrezik për një shfaqësime për shkak të provave të dobëta ose të pamjaftueshme, gjyqtarët do të jepnin vendime të fajsisë në dënime të pezulluara. Kjo thuhet se është bërë për të shmangur publicitetin negativ dhe për të parandaluar të pandehurit që të padisin për dëmet që rrjedhin nga rastet e paraburgimit të padrejtë.

Pjesëmarrja e grave dhe minoriteteve: Nuk ka ligj që kufizon pjesëmarrjen e grave dhe prestarëve të minoriteteve në procesin politik, dhe gratë dhe minoritetet kanë marrë pjesë në të. Sipas ligjit, listat e kandidatëve të secilës parti politike për zgjedhjet parlamentar dhe lokale duhet të kenë shumëllojshmëri gjinore. Jo më shumë se dy të tretat e kandidatëve të listës mund t'i takojë gjinisë së njëjtë. Më 28 shtator, 41 nga 120 deputetët ishin gra dhe katër gra ishin pjesë e kabinetit qeveritar që numëron 5 ministra. Burrat kanë dominuar vendet udhëheqëse në partitë politike. Nga 208 kandidatët për postet e kryetarit të komunës në zgjedhjet e 15 tetorit, vetëm 12 ishin gra. Gjashtë gra fituan garën për kryetar komune më 15 tetor, katër prej të cilëve kanë qenë në pozitën e njëjtë paraprakisht.

Shqiptarët dhe pakicat e tjera etnike kanë vazhduar të ankohen për përfaqësimin e pabarabartë në kuadër të qeverisë dhe për praktikat diskriminuese që i përjashtonte ata nga pjesëmarrja politike, siç është lëshimi selektiv i certifikatave të sigurisë.

#### **Pjesa 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në Qeveri**

Ligji parasheh ndjekje penale për korrupsionin e zyrtarëve, ndonëse ka pasur raporte se zyrtarët e përfshirë në korrupsion nuk janë ndëshkuar.

OJQ-të kanë theksuar rolin dominues të qeverisë në ekonomi që ka krijuar mundësitë për korrupsion. Qeveria ka qenë punëdhënësi më i madh në vend, dhe disa analistë kanë vlerësuar se ajo punëson mbi 180.000 persona, pavarësisht se statistikat zyrtare tregojnë se punësimin në sektorin publik është rreth 128,000.

Korrupsioni: Më 30 mars, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar lëshoi raportin e saj dyvjeçar, ku pohon se Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit kishte humbur besimin e qytetarëve dhe nuk kishte arritur të përmbushë përgjegjësitë e monitorimit dhe kontrollit. Në vitin 2016 qendra konstatoi se korrupsioni është rritur që nga viti 2014 dhe se prezenca e korrupsionit ka mbetur e lartë në mesin e publikut. Gjatë vitit, 30.5 për qind e 1.000 të anketuarve në një sondazh të kryer nga organizata kanë raportuar se nga ata është kërkuar rryshfet, deri 4.9 për qind në vitin 2014. Në mënyrë të ngjashme, 29.2 për qind e të anketuarve kanë ofruar ose kanë dhënë rryshfet, deri 7.7 për qind në vitin 2014. Korrupsioni ka ndryshuar edhe përgjatë vijave etnike, me 83.3 për qind e shqiptarëve etnik që kanë thënë se i janë nënshtruar presionit të paguajnë rryshfet dhe 80.5 për qind janë duke paguar rryshfet, krahasuar me 40.6 për qind dhe 35.5 për qind, respektivisht, të të anketuarve maqedonas.

Sipas Barometrit Global vjetor të Korrupsionit të Transparency International i lëshuar në nëntor të vitit 2016, 12 për qind e të anketuarve kanë raportuar se është dashur të paguajnë rryshfet për të marrë shërbime publike për të cilat ata kanë pasur të drejtë ligjore. Të gjithë të anketuarit besojnë se njerëzit e fuqishëm, me ndikim, dhe të pasur ushtrojnë ndikim shumë të fortë mbi politikën.



Gjatë tre muajve të parë të vitit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka hapur 16 raste për shpërdorim të fondeve publike.

Gjatë vitit, Zyra e Prokurorit për Krim të Organizuar dhe Korrupsion ka hetuar 25 të dyshuar për akuza të lidhura me korrupsion, ka ngritur 1 padi, dhe ka fituar katër dënime kundër të pandehurve. Krimet kanë përfshirë shpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar, pastrimin e parave ose pastrimin e të ardhurave të tjera kriminale, mitmarrje, dhe pranimin e shpërblimit për ndikim të paligjshëm. Deri më 15 shtator, Prokuroria Themelore e Shkupit kishte dy anëtarë të parlamentit nën hetim për shkelje të rregullave të përcaktuara nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Nga 15 prilli deri më 15 shtator, Prokuroria Speciale ka ngritur 18 aktakuza kundër 120 të pandehurve, ka ngritur 168 padi për vepra penale dhe ka hapur shtatë hetime kundër 25 të dyshuarve. Po ashtu ka iniciuar 142 hetime paraprake për sjellje evidente kriminale në lidhje me ose që dalin nga përmbajtja e komunikimeve të përgjuara në mënyrë të paligjshme gjatë periudhës prej viti 2008 deri në vitin 2015. Në depozitimet e saj më 30 qershor, Prokuroria Speciale ka rekomanduar paraburgimin e 18 prej tyre, duke përfshirë këtu edhe ish kryeministrin Gruevski. Gjykata Themelore e Shkupit ka refuzuar kërkesën për të paraburgosur Gruevskin (shih pjesën 1.d.).

Që nga krijimi i Zyrës së Prokurorisë Speciale në vitin 2015, partia VMRO-DPMNE në pushtet në mënyrë të vazhduar ka penguar punën e zyrës dhe ka kritikuar publikisht Prokuroren Speciale Katica Janeva, duke pretenduar se ajo është e paafte dhe instrument politik i njëanshëm i partisë opozitare LSDM. Gjyqësori ka luajtur rol për të penguar efektivitetin e Zyrës së Prokurorisë Speciale.

Më 1 nëntor, policia arrestoi ish- kryetarin e komunës së Gjorçe Petrov, të Shkupit, Sokol Mitrevski dhe nëntë të dyshuar të tjerë për shpërdorim të detyrës. Akuzat kanë të bëjnë me lëshimin e pretenduar të licencave të paligjshme të ndërtimit dhe koncesioneve të tokës. Arrestimi ndodhën ma hetimeve të pesë kryetarëve ose ish kryetarëve të komunave nga radhët e partisë VMRO-DPMNE lidhur me akuza të ndryshme për korrupsion.

Deklarimet financiare: Ligji për anti-korrupsion kërkon që zyrtarët e emëruar dhe të zgjedhur, së bashku me familjet e tyre të afërta, t'i deklarojnë të ardhurat dhe pasurinë, duke paraparë dënime për shkelje të ligjit. Qytetarët kanë pasur mundësi t'i shohin deklaratimet në ueb-faqen e Komisioni Shtetëror Kundër Korrupsionit. Komisioni gjithashtu ka pranuar dhe kontrolluar 1.460 deklaratata të konfliktit të interesit të paraqitura nga zyrtarë publikë.

Gjatë verës, media raportuan rreth deklaratave të pasurisë të zyrtarëve të rinj qeveritarë, veçanërisht Zëvendës Kryeministrit Koço Angjushev, një biznesmen që ka raportuar një vlerë neto prej 27 deri 28 milionë euro (32 milionë dollarë deri në 33 milion dollarë) në deklaratën e tij të pasurisë. Pas emërimit të tij, Angjushev nuk u tërhoq nga kompania e tij Feroinvest, por u largua si drejtor menaxhues. Grupi Feroinvest zotëron biznese në sektorin e përpunimit të metaleve dhe të energjisë së rinovueshme. Më 19 shtator, Angjushev njoftoi se kompanitë e tij nuk do të konkurronin më në tenderë qeveritarë, ndërkohë që ai do të ishte në detyrë pasi ELEM, kompania shtetërore e prodhimit të energjisë, anuloi një tender ku Feroinvest ishte më përparësi për ta fituar.

## **Pjesa 5. Qëndrimi qeveritar ndaj hetimeve ndërkombëtare dhe joqeveritare për abuzime të pretenduara të të drejtave të njeriut**

Grupet vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në përgjithësi kanë vepruar pa kufizime qeveritare dhe i kanë hetuar dhe publikuar gjetjet e tyre mbi të drejtat e njeriut. Zyrtarët

qeveritarë kanë bashkëpunuar duke i dëgjuar këto grupe por ngandonjëherë nuk kanë reaguuar ndaj vështrimeve të tyre. Gjatë vitit një disa ministri formuan grupe punuese që përfshinin anëtarë të shoqërisë civile, dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile u ftuan të merrnin pjesë në debatet parlamentare.

Në dhjetor 2016 autoritetet tatimore nisën inspektimin në 20 organizata të shoqërisë civile. Zyra e të ardhurave publike synonte OJQ-të që kishin qenë kritike ndaj politikave të qeverisë së udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Drejtoria e të Ardhurave Publike ka kryer auditime në javët pas zgjedhjeve të muajit dhjetor 2016, që kanë përkuar me thirrjet e ish-kryeministrit dhe liderit të VMRO-DPMNE-së Nikolla Gruevski për "de-Sorosoizim" të vendit. Më vonë doli në sipërfaqe se 42 anëtarë të opozitës që kanë kritikuar haptazi qeverinë e mëparshme gjithashtu i janë nënshtruar auditimit dhe hetimeve. Kritikët e auditimeve, përfshirë edhe Avokatin e Popullit, i kanë quajtur ato një "gjueti shtrigash". Raportuesi special i Parlamentit Evropian, Ivo Vajgl gjithashtu ka shprehur shqetësimin e tij rreth auditimeve, duke i quajtur "sulme radikale dhe të pajustificuara publike mbi organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e huaj nga politikanët dhe mediat", në raportin e tij të 23 janarit.

Më 3 shkurt, Prokuroria Publike për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin filloi të kryente hetime të veçanta paraprake për 13 OJQ që tashmë janë nën hetim nga Zyra e të Ardhurave Publike. Në periudhën prej 27 shkurtit dhe 7 marsit, përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme kanë vizituar 13 organizata nën hetim. Më 17 nëntor, ministri i brendshëm ka njoftuar se hetimet e Prokurorisë Publike kishin përfunduar dhe se nuk është konstatuar asnjë shpërdorim me përjashtim të një akuze për evazion fiskal në shkallë të vogël. Deri në fund të vitit, Zyra e të Ardhurave Publike ende nuk kishte mbyllur zyrtarisht hetimet e saj.

Kombet e Bashkuara ose organet e tjera ndërkombëtare: Qeveria ka punuar me disa organizata nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë edhe UNICEF-in, Programin zhvillimor të OKB-së, dhe UNHCR-në, si dhe organizata të tjera ndërkombëtare duke u fokusuar në financat, mbrojtjen shëndetësore, migracionin dhe refugjatët, si dhe çështjet e sigurisë.

Organet qeveritare për të drejtat e njeriut: Avokati i Popullit ka punuar në drejtim të mbrojtjes së qytetarëve nga shkeljet e të drejtave të tyre nga institucionet publike, uljes së diskriminimit ndaj bashkësive pakicë dhe personave me nevoja të posaçme, promovimit të përfaqësimit të barabartë në jetën publike, si dhe trajtimit të të drejtave të fëmijëve. Qeveria nuk ka siguruar burime të mjaftueshme për zyrën e Avokatit të Popullit dhe të njëjtit nuk ia ka deleguar kontrollin mbi buxhetin e tij.

Komisioni shtatë-anëtarësh për Mbrojtje nga Diskriminimi ka mandat për shqyrtimin e ankesave për diskriminim, dhënien e rekomandimeve dhe promovimin e zbatimit të ligjit antidiskriminim. Komisioni nuk ka fuqi për ndëshkimin e kundërvajtësve. Ndryshe nga Avokati i Popullit, Komisioni i ka shqyrtuar ankesat nga sektori publik dhe ai privat. Qytetarët që nuk janë të kënaqur nga rezultati mund t'u drejtohen gjykatave, të cilat mund ta pranojnë mendimin e shkruar të Komisionit si dëshmi.

## **Pjesa 6. Diskriminimi, shpërdorimet shoqërore dhe trafikimi me qenie njerëzore**

### **Gratë**

Dhunimi dhe dhuna në familje: Dhunimi, përfshirë edhe dhunën bashkëshortore është i kundërligjshëm. Dënimet për dhunim lëvizin prej një deri në 15 vite burg, por ka zbatim të dobët të ligjit. Dhuna në familje është e paligjshme, por ishte një problem i vazhdueshëm dhe i përhapur. Policia dhe zyrtarët gjyqësorë kanë ngurruar ta ndjekin dhunën bashkëshortore dhe dhunën në familje. Deri në shtator, zyra e Avokatit të Popullit nuk kishte marrë ndonjë ankesë

për veprim joadekuat nga policia apo sistemi gjyqësor në hetimin ose ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje.

Qeveria ka drejtuar shtatë qendra për strehim me kapacitet të kufizuar dhe një OJQ operonte një qendër strehimi me kapacitet prej 30 grave në rrezik. Një OJQ vendase ka operuar me një kontakt-linjë telefonike në maqedonisht dhe shqip, si dhe me dy qendra krize për strehim të përkohshëm të viktimave të dhunës në familje.

Ngacmimi seksual: Ligji e ndalon ngacmimin seksual në vendin e punës dhe jep udhëzime për shqiptimin e dënimit prej tre muaj deri në tre vite burg. Ngacmimi seksual i femrave në vendin e punës ka qenë problem dhe në përgjithësi, viktimat nuk i kanë denoncuar rastet e këtilla për shkak të frikës nga publiciteti dhe humbja e mundshme e vendit të punës.

Detyrim në kontrollin e popullsisë: Nuk ka pasur raportime për abort të detyruar, sterilizimin e pavullnetshëm ose metoda të tjera të kontrollit të popullsisë. Vlerësimet mbi vdekshmërinë e nënave dhe prevalencën kontrceptive janë në dispozicion në: [www.who.int/reproductivehealth/publications/monitoring/maternal-mortality-2015/en/](http://www.who.int/reproductivehealth/publications/monitoring/maternal-mortality-2015/en/)

Diskriminimi: Femrat kanë status të njëjtë juridik si edhe meshkujt. Në disa bashkësi, femrat janë privuar nga e drejta e votës nga ndonjë mashkull i familjes, që e ka udhëzuar votimin ose ka votuar në emër të anëtareve të familjes.

## **Fëmijët**

Regjistrimi i lindjes: Ligji e përcakton shtetësinë në radhë të parë sipas shtetësisë së prindërve. Ai gjithashtu parashihet mundësinë fitimit të shtetësisë për fëmijët e gjetur në territorin e vendit nëse nuk njihen prindërit, përderisa autoritetet nuk zbulojnë që prindërit janë të huaj para moshës 18-vjeçare të fëmijës. Të gjitha lindjet në spitale dhe institucione mjekësore janë regjistruar automatikisht dhe ligji kërkon që të gjithë fëmijët, përfshirë edhe ata që kanë lindur në shtëpi, të regjistrohen në zyrat e ofiqarit brenda 15 ditëve nga dita e lindjes. Disa familje rome e kanë vonuar regjistrimin e foshnjave të lindura, duke ia vështirësuar atyre qasjen në përfitimet arsimore, mjekësore dhe përfitime tjera në jetë, për shkak të mungesës së dokumenteve të identifikimit.

Keqpërdorimi i fëmijëve: Keqpërdorimi i fëmijëve ka qenë problem në disa rajone. Qeveria ka operuar me një linjë telefonike për dhunën në familje, përfshirë edhe keqtrajtimin e fëmijëve.

Martesa e detyruar dhe e hershme: Moshë minimale ligjore për martesë është moshë 18-vjeçare. Gjykata mund ta lejojë martesën për personat e moshës 16-18 vjeçare, në qoftë se konstaton se kanë aftësi mendore dhe fizike për martesë. Martesat e detyruara dhe të hershme kanë ndodhur tek bashkësia rome dhe në masë shumë më të vogël në bashkësinë etnike shqiptare.

Eksplotimi seksual i fëmijëve: Ligji ndalon çdo lloj të eksploatimit të fëmijëve për qëllimet e seksit komercial. Dënimet për eksploatimin e fëmijëve për qëllimet e seksit komercial përcaktohen prej 10 deri në 15 vite burg. Ligji e ndalon pornografinë e fëmijëve dhe dënimet për këtë janë prej pesë deri në 15 vite burg. Moshë minimale për marrëdhënie seksuale me pajtim është moshë 16-vjeçare. Prostitucioni fëmijëror është konsideruar si problem nga autoritetet, por nuk i kanë ditur përmasat. Shteti ka regjistër on-line, ku mund të kërkohet sipas emrit dhe adresës së personave të dënuar për trafikim të fëmijëve dhe keqpërdorim seksual të fëmijëve, ku jepen fotografi, evidenca të dënimit, si dhe adresat e banimit të të dënuarve. Kryerësit e veprës mund të kërkojnë të mënjanohen nga lista 10 vite pas vuajtjes së dënimit, me kusht që të mos e kenë përsëritur veprën.

Fëmijët e zhvendosur: Sipas Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale në qershor ka pasur 78 fëmijë të zhvendosur me prejardhje të ndryshme etnike. Një raport në muajin tetor të viti 2016 nga Zyra e Avokatit të Popullit ka vlerësuar se 236 fëmijë jetonin pa strehë. Me mbështetje ndërkombëtare, Ministria ka drejtuar dy qendra ditore për fëmijët e rrugës. Qeveria ka administruar një strehimore transiti për fëmijët e rrugës, por efektiviteti i saj për të siguruar shërbime përkatëse sociale ka qenë i kufizuar si rrjedhojë e sipërfaqes së vogël.

Fëmijët e institucionalizuar: Mbështetësit dhe Avokati i Popullit kanë raportuar për mungesë të llogaridhënies lidhur me rastet e moskujdesit dhe keqpërdorimit të fëmijëve në jetimore, strehimore dhe qendrat e paraburgimit. OJQ-të dhe UNICEF kanë qenë aktive në këtë fushë. Në qershor të viti 2016, Avokati i Popullit ka paraqitur raportin e tij lidhur me Burgun e Tetovës për të mitur, duke e përshkruar jetesën dhe kushtet sanitare çnjerëzore në objektin e burgut, praktikat shqetësuese të trajtimit nga gardianët e burgut, si dhe mungesën e kujdesit mjekësor. Sipas Zyrës së Avokatit të Popullit, nevojat fiziologjike dhe sanitare kanë qenë të paplotësuara; nuk ka pasur asnjë mjek të përhershëm në detyrë; ndërsa hepatiti është përhapur me anë të marrëdhënieve seksuale në mesin e djemve, disa prej të cilëve kanë qenë viktimë të abuzimit seksual.

Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve: Shteti është palë-nënshkruese e Konventës së Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve (1980). Për informata konkrete, vizitoni faqen e internetit të Departamentit të Shtetit: [http://travel.state.gov/abduction/country/country\\_3781.html](http://travel.state.gov/abduction/country/country_3781.html).

## **Anti-Semitizmi**

Bashkësia hebraike ka vlerësuar se rreth 200-250 hebraikë kanë jetuar në vend. Ka pasur disa raste të fjalës anti-semite në mediat sociale dhe bashkësia hebreje ka raportuar se janë hedhur në fletushka me përmbajtje anti-semite në oborrin e selisë së saj.

## **Trafikimi me qenie njerëzore**

Shikoni *Raportin e Departamentit të Shtetit për trafikimin me qenie njerëzore* në

[www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/](http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/).

## **Personat me nevoja të posaçme**

Ligji e ndalon diskriminimin e personave në bazë të aftësive të kufizuara fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore, por Qeveria nuk i ka zbatuar gjithmonë këto dispozita në mënyrë efektive. Ligji u lejon atyre që pretendojnë se janë diskriminuar të parashtrojnë ankesa në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Komisioni ishte i vendosur në zyrë që ngandonjëherë pa qasje për personat me nevoja të veçanta.

Një fond i veçantë qeveritar për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara rregullohet me ligj të posaçëm. Agjencia e Punësimit e menaxhon fondin, nën mbikëqyrje të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Ky fond ka siguruar grante për rindërtimin e zyrave ose për furnizimin me pajisje të zyrave, për të siguruar kushte të arsyeshme për persona me nevoja të veçanta. Sipas ligjit, personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore duhet të marrin aprovim nga komisioni mjekësor i Qeverisë, për të shërbyer në pozita mbikëqyrëse në sektorin privat dhe atë qeveritar.

Ligji kërkon që ndërtesat e reja të ndërtohen sipas standardeve për qasje të lehtë, ndërsa objektet ekzistuese publike duhej ta mundësojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara deri në vitin

2015. OJQ-të kanë raportuar se godinat publike nuk janë në pajtim me ligjin. Ndonëse të gjithë autobusët e blerë që në vitin 2013 nga Qeveria për Qytetin e Shkupit kanë mundur qasje të lehtë, transporti publik, në masë të madhe nuk kanë ofruar akses për personat me aftësi të kufizuara në regjionet e tjera, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ka vazhduar projektin disavjeçar për furnizim me vagonë të rinj, si dhe për rinovimin e stacionit të trenit në Shkup dhe në 10 qytete tjera, për t'i harmonizuar me standardet e qasjes së lehtë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë përpjekje për të siguruar mbështetje adekuata për t'ua mundur vijimin e rregullt të procesit mësimor fëmijëve me aftësi të kufizuara. Janë punësuar edukatorë të posaçëm, të cilët i janë deleguar nëpër shkolla të caktuara ose si edukatorë "të lëvizshëm" në nivel komunal, për t'i mbuluar të gjitha shkollat e komunës, duke i mbështetur mësimdhënësit të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara në klasat me mësim të rregullt. Përveç kësaj, autoritetet shkollore kanë instaluar ashensorë në disa shkolla fillore, si dhe teknologji për t'u ndihmuar nxënësve me aftësi të kufizuara, duke i shfrytëzuar kompjuterët në shkollat e zgjedhura fillore dhe të mesme. Pavarësisht përpjekjeve të cekura, një numër i madh i nxënësve me aftësi të kufizuara edhe më tej mësimin e ndjekin në shkollat të veçanta.

### **Minoritetet nacionale/racore/etnike**

Sipas regjistrimit të vitit 2002, përbërja e popullatës ka qenë: 64.2% maqedonas, 25.2% shqiptarë, 3.9% turq, 2.7% romë, 1.8% serb, 0.8% boshnjakë dhe 0.5% vllleh. Sipas raportit vjetor të Avokatit të Popullit, pakicat etnike, me përjashtim të serbëve dhe vlllehve, kanë pasur përfaqësim më të ulët në shërbimin publik dhe institucionet tjera shtetërore, përfshirë edhe ushtrinë, policinë, agjencitë e zbulimit, si dhe gjykatat, bankën nacionale, doganat dhe ndërmarrjet publike.

Ligji e mundëson arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhën maqedonase, shqipe, rome, turke dhe serbe. Numri i nxënësve të pakicave që e kanë vijuar arsimin e mesëm në gjuhën e tyre amtare ka vazhduar të rritet, veçanërisht pas shpalljes së arsimit të mesëm si obligues në vitin 2007, megjithëse Qeveria nuk ka pasur mundësi të sigurojë mësimdhënie të plotë në gjuhën rome, për shkak të mungesës së mësimdhënësve të kualifikuar.

Shqiptarët etnik kanë vazhduar të kritikojnë përfaqësimin e pabarabartë në ministritë qeveritare dhe ndërmarrjet publike. Në Akademinë Policore në vend ka vazhduar të shënojë rënie numri i të trajnuarve nga minoritetet që të jetë në pajtim me Kushtetutën, e cili përcakton që administrata të pasqyrojë përbërjen etnike të shtetit. Shqiptarët etnikë kanë pretenduar se Qeveria ka projektuar procesin e testimit në akademinë padrejtësisht duke mohuar qasjen e shqiptarëve dhe minoriteteve të tjera. Në veçanti, shqiptarët etnikë janë ankuar për paragjykimet kulturore në testet. Përfaqësimi etnik i shqiptarëve dhe minoriteteve të tjera brenda stafit civil të Ministrisë së Mbrojtjes ka mbetur i ulët. Disa njësi elite të policisë dhe ushtrisë nuk kanë pothuajse asnjë përfaqësues të minoriteteve etnike.

Marrëdhëniet mes bashkësisë etnike maqedonase dhe asaj shqiptare shpeshherë kanë qenë të tensionuara. Disa incidente ndëretnike, kanë shkaktuar protesta, duke i rritur tensionet mes dy bashkësive më të mëdha. Shqiptarët etnikë kanë vazhduar të ankohen për përfaqësimin e pabarabartë në ministritë qeveritare dhe ndërmarrjet publike.

Romët kanë raportuar diskriminim të gjerë shoqëror. OJQ-të dhe ekspertët ndërkombëtarë kanë raportuar se romët shpeshherë janë refuzuar për punësim, ndërsa disa romë janë ankuar për mungesë të qasjes deri te fondet për mirëqenie publike. Ministria e Shëndetësisë dhe OJQ Hera, në partneritet me UNICEF, kanë sponsorizuar Programin e Ndërmjetësuesve të Shëndetit të Romëve për të ofruar shërbime të zhvillimit shëndetësor, social dhe të fëmijërisë së hershme në

shtatë komuna me numër të madh të popullsisë rome.

Turqit etnikë janë ankuar për diskriminim.

### **Aktet e dhunës, diskriminimit, dhe abuzime të tjera në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor**

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, Marrëdhëniet seksuale midis anëtarëve të të njëjtit seks janë të ligjshme.

Komuniteti LGBTI ka mbetur i marginalizuar dhe aktivistët që mbështesin të drejtat e LGBTI kanë raportuar incidente të shumta të paragjykitimit shoqëror, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes, sulmet fizike dhe dhunë tjetër, mosveprimi i policisë për të arrestuar autorët e sulmeve, dhe mosdënimi dhe mosluftimi i diskriminimit të komunitetit LGBTI nga Qeveria. Pesë raste të kimit nga urrejtja kundër individëve transgjinorë janë raportuar gjatë vitit. Sipas OJQ-së Fronti Subverziv, deri më 1 shtator, Prokuroria Publike në Shkup nuk ka proceduar mbi 90 rastet në pritje që përfshijnë krime të urrejtjes që kanë në shënjestër anëtarë të komunitetit LGBTI.

Sipas OJQ-ve, ka pasur një mungesë të vullnetit në mesin e partive politike për të trajtuar problemin e dhunës dhe diskriminimit ndaj individëve të komunitetit LGBTI. Përfaqësues të Qeverisë zakonisht kanë munguar në diskutimet publike mbi çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin LGBTI.

Një grup jozyrtar LGBTI ndër parlamentar u krijua në qershor, kur kryeministri lëshoi një deklaratë mbi përfshirjen e komunitetit LGBTI.

Në qershor, qeveria e re mbështeti Javën e Krenarisë dhe, për herë të parë, Ministri i kulturës foli në një ngjarje krenarie. Më 1 janar hyri në fuqi një memorandum bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Qendrës për Mbështetje të LGBTI dhe Zyrës së Avokatit të Popullit.

Më 22 shtator, Gjykata Administrative solli një vendim me të cilin kërkon nga Ministria e Drejtësisë të korrigjojë regjistrimin e një personi transgjinor në regjistrin e lindjes sipas kërkesës. Vendimi gjithashtu detyron Ministrinë e Brendshme që të lëshojë një numër të ri amë për kërkuesin brenda tre ditëve nga korrigjimi.

Si rezultat i ankesave të organizatave LGBTI dhe me mbështetjen e Avokatit të Popullit, Ministria e Arsimit tërhoqi një numër tekstesh shkollore të cilat u konsideruan diskriminuese në bazë të statusit gjinor dhe familjar. Universitetet shtetërore Shn. Qirili dhe Metodi dhe Shn. Klimenti i Ohrit nuk u pajtuan me urdhërim, ndërsa në këto institucione në tetor ende ishin në përdorim tekste diskriminuese.

### **Stigmatizimi shoqëror për HIV dhe AIDS**

Ka pasur raporte të izoluara të diskriminimit kundër personave me HIV/AIDS në sektorin e kujdesit shëndetësor.

## **Pjesa 7. Të drejtat e punëtorëve**

### **a. Liria e Shoqërimit dhe e drejta për marrëveshje kolektive**

Ligji e parasheh të drejtën e themelimit dhe anëtarësimit në sindikata të pavarura, marrëveshje kolektive dhe të drejtën e grevës. Ligji ndalon diskriminimin për aktivitete sindikaliste dhe siguron kthimin në punë të punëtorëve të larguar nga puna për këtë arsye.

Ligji kërkon që sindikatat e bashkuara të regjistrohen në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe në Regjistrin Qendror të Shtetit. Udhëheqësit e sindikatave kanë raportuar për rastet kur ministria e ka zgatur procesin e regjistrimit për muaj të tërë pa shpjegim.

Një gjykatë e juridiksionit të përgjithshëm mund të ndërpresë aktivitetet sindikale me kërkesë të Regjistrimit Qendror ose gjykatës kompetente, kur këto aktivitete konsiderohen të jenë "kundër kushtetutës dhe ligjit." Nuk ka kufizime shtetësie për anëtarësimin në sindikata, ndonëse shtetasit e huaj duhet të kenë leje të vlefshme pune dhe të jenë të punësuar nga kompania ose organi qeveritar i përcaktuar në lejen.

Qeveria dhe punëdhënësit nuk kanë respektuar gjithmonë lirinë e shoqërimit, të drejtën e grevës dhe të drejtën e Marrëveshjes Kolektive. Sindikatat kanë pohuar se dispozita "përjashtuese" të ligjit ka lejuar punëdhënësit të përjashtojnë deri në 2 për qind të punëtorëve nga negociatat kolektive gjatë grevës. Marrëveshja kolektive lejohet vetëm për sindikatat që përfaqësojnë të paktën 20 për qind të të punësuarve dhe shoqatat e punëdhënësve që përfaqësojnë të paktën 10 për qind të punëdhënësve në nivel në të cilin është lidhur Marrëveshja (kompani, sektori, ose vendi). Mjetet qeveritare të ekzekutimit dhe mjetet juridike kanë qenë të pamjaftueshme. Dënimet për shkelje të ligjit nuk kanë mjaftuar për t'i penguar ato. Procedurat administrative dhe gjyqësore përgjithësisht kanë pësuar vonesa të gjata.

Në shkurt, si përgjigje ndaj një raporti të Komitetit të Ekspertëve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës të vitit 2017, Ministria e Arsimit ndryshoi ligjin për të ndaluar zëvendësimin e punëtorëve grevistë.

Sindikatat, me përjashtim të disa sindikatave sektoriale, në përgjithësi nuk kanë qenë të pavarura nga ndikimi i zyrtarëve të qeverisë, partive politike, dhe punëdhënësve, veçanërisht ato që kanë pasur lidhje të ngushta me koalicionin qeverisës të mëparshëm.

Më 14 gusht, Zhivko Mitrevski dha dorëheqje nga posti i kreut të Federatës së Sindikatave. Federata e kishte shkarkuar Mitrevskin në nëntor 2016 pasi ai kishte pezulluar katër sindikata që e kishin akuzuar atë për shpërdorimin e detyrës, duke keqpërdorur fondet dhe duke ndërhyrë në punën e sindikatës. Pavarësisht zgjedhjes së Darko Dimovskit nga ana e Federatës si kryetar i përkohshëm, ish-ministri i punës dhe politikës sociale Ibrahim Ibrahimi rivendosi Mitrevskin në këtë pozitë. Në maj, Gjykata Supreme vendosi që Dimovski të regjistrohej si kryetar.

## **b. Ndalimi i punës së detyruar**

Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë të gjitha format e punës së detyruar, ndërsa Qeveria ka zbatuar në masë të madhe ligjet në fuqi. Ligji parashikon një dënim me burg për shkelje në lidhje me punën e detyruar apo për shkatërrimin ose për marrjen e dokumentit të identifikimit, pasaportës apo dokumenteve të tjera të udhëtimit. Ka pasur raste në të cilat gratë dhe fëmijët i janë nënshtruar punës së detyruar, siç është shitja e artikujve të vegjël, në restorante dhe bare. Disa fëmijë romë kanë qenë të detyruar të lypin, shpesh nga të afërmit (shih pjesën 7.c.).

*Gjithashtu shih Raportin e Departamentit për Trafikimin me Qeniet Njerëzore*  
[www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/](http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/).

## **c. Ndalimi i punës së fëmijëve dhe mosha minimale për punësim**

Mosha minimale për punësim është 15 vjeç, ndonëse fëmijët e moshës 14-vjeçare mund të punojnë si praktikantë ose si pjesë e programit zyrtar edukativ. Ligji e ndalon punësimin e të miturve nën moshën 18-vjeçare në vendet e punës që e dëmtojnë shëndetin e tyre psikik ose psikologjik, si dhe moralin.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve që e rregullojnë punësimin e fëmijëve. Qeveria bëri përpjekje për të zbatuar ligjin në ekonominë formale, por nuk e ka bërë këtë në mënyrë efektive në ekonominë joformale. Policia dhe Ministria e Punës, përmes qendrave për punë sociale, janë përgjegjëse për zbatimin e ligjeve mbi trafikimin e fëmijëve duke përfshirë lypjen e detyruar. Ligji parasheh dënime me burg, për personat që blejnë, shesin, mbajnë, ose marrin të mitur me qëllim të shfrytëzimit. Nëse zbatohen, këto dënime do të jenë të mjaftueshme për të parandaluar shkeljet.

Edhe pse puna e fëmijëve nuk ka qenë e përhapur në vend, ka pasur raporte se individë në ekonominë joformale kanë përdorur punën e fëmijëve. Shembujt më të zakonshëm kanë qenë përdorimi i fëmijëve për të lypur, pastrimi i xhamave të makinave, dhe shitja e cigareve dhe sendeve të tjera të vogla në tregjet e hapura, rrugët, apo në bare dhe restorante të natës. Ndonëse ekzistojnë ligjet e nevojshme në vend, përpjekjet e Qeverisë për eliminimin e keqpërdorimit të punës së fëmijëve kanë qenë kryesisht të paefektshme. Fëmijët e përfshirë në këto aktivitete kanë qenë kryesisht romë dhe kanë punuar për prindërit e tyre ose familjarët. Zyrtarët shpesh nuk kanë arritur të marrin në përgjegjësi ata që i kanë shfrytëzuar fëmijët, ndërkaq fëmijët romë kanë mbetur të pambrojtur nga shfrytëzimi dhe puna e detyruar.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka financuar dy qendra të kujdesit ditor ku është siguruar edukimi, shërbimet mjekësore dhe psikologjike për fëmijët që detyrohen të kërkojnë lëmshë në rrugë. Ministria e Punës gjithashtu ka bashkë financuar një qendër të kujdesit ditor që drejtohet nga një OJQ në lagjen e Shkupit, Shuto Orizarë.

Fëmijët i janë nënshtruar shfrytëzimit seksual për qëllime seksuale, një nga format më të këqija të punës së detyruar të fëmijëve (shih pjesën 6, Fëmijët).

Lexoni edhe *Konstatimet e Departamentit të Punës për format më të këqija të punës së fëmijëve* në [www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/](http://www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/).

#### **d. Diskriminimi në lidhje me punësimin ose profesionin**

Ligjet dhe rregulloret e punës në përgjithësi e ndalojnë diskriminimin në lidhje me racën, gjininë, aftësitë e kufizuara, gjuhën, orientimin seksual, gjendjen shëndetësore, apo statusin shoqëror. Ligji nuk adreson diskriminimin në bazë të virusit HIV apo ndonjë statusi me ndonjë sëmundje tjetër ngjitëse. Qeveria jo gjithmonë i ka zbatuar ligjet në mënyrë efektive. Aktivistët civilë janë ankuar se Komisioni Shtetëror për Mbrojtje nga Diskriminimi nuk është duke e bërë punën e tij dhe se shërben thjesht si një qendër punësimi për individët e afërt me partinë e mëparshme në pushtet.

Diskriminim në punësim dhe profesion ka pasur në baza gjinore, në bazë të aftësisë së kufizuar dhe në bazë të grupeve të caktuara etnike në ushtri, polici, shërbimet e inteligjencës, gjykata, Bankën Kombëtare, në shërbimin doganor, agjencitë shtetërore dhe kompanitë publike dhe private (shih pjesën 6, Minoritete nacionale/racore/etnike). Pavarësisht nga përpjekjet e Qeverisë dhe ndryshimet ligjore për përfshirjen e detyrueshme në arsimin fillor dhe të mesëm, bashkësia romë ka vazhduar të jetojë në grupe të veçuara, pa shëndetësi përkatëse dhe pa mbrojtje sociale. Të dhënat nga Zyra Shtetërore e Punësimit kanë treguar se për shkak të pjesëmarrjes së ulët në sistemin arsimor, veçanërisht në arsimin e lartë, romët në përgjithësi kanë pasur vështirësi në gjetjen e një punë në ekonominë formale. Pagat e grave ngecin pas atyre të burrave dhe të pakta



kanë qenë gratë në poste drejtuese. Personat me nevoja të posaçme janë ballafaquar me diskriminim në punësim dhe në qasje në vendin e punës.

#### **d. Kushtet e pranueshme të punës**

Më 19 shtator, Kuvendi solli ligjin për rritje të pagës minimale në nivel nacional nga 10,080 denarë në muaj në 12,000 denarë (231 dollarë). Ky ndryshim i përfshin edhe punëtorët në industrinë e tekstilit dhe lëkurës, ku paga minimale paraprake ishte 8,080 denarë (\$ 155) në muaj. Që nga qershori, sipas statistikave zyrtare, paga mesatare mujore neto ka qenë 22,808 denarë (439 dollarë). Në tetor, Enti Shtetëror i Statistikës ka vlerësuar se 21.8 për qind e popullsisë jetonte në ose nën pragun e varfërisë. Pragu i varfërisë është llogaritur në nivel të të një të ardhur mujore prej 14,500 denarë (279 \$) për një familje katër anëtarëshe.

Megjithëse Qeveria ka vendosur standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë për punëdhënësit, këto standarde nuk janë zbatuar në sektorin joformal, të cilat përbënin rreth 22 për qind të ekonomisë.

Inspektorët e punës kanë të drejtë të ngrenë padi kundërvajtëse kundër punëdhënësit dhe ta mbyllin ndërmarrjen, deri në korrigjimin e shkeljeve. Në rast të përsëritjes së shkeljes, pronari mund të gjobitet. Numri i përgjithshëm i inspektorëve është vlerësuar adekuat për të hetuar shkeljet e ligjit të punës dhe dënimet kanë qenë të mjaftueshme për t'i parandaluar shkeljet. Në praktikë, inspektimet nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar pajtueshmërinë pjesërisht për shkak të një shpërndarje joadekuate rajonale të inspektorëve. Gjatë vitit, Inspektorati i Punës në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale ka paraqitur padi kundër disa ndërmarrjeve për detyrimin e punëtorëve të punojnë me orar të gjatë pa pushimin e paraparë me ligj, mospagesën e rrogave, përfitimeve dhe punës jashtë orarit, si dhe për shkurtimin e pushimit të të punësuarve. Shkelje të jashtëzakonshme janë konstatuar sa u përket pagave dhe punës në sektorin e tekstilit, hekurudhave dhe shitjes me pakicë.

Paga minimale, orët e punës, si dhe standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Shumë punëdhënës kanë punësuar punëtorë duke vepruar në kundërshtim me ligjin, ndërsa bizneset e vogla të tregtisë shpeshherë kërkojnë që të punësuarit të punojnë edhe përtej kufijve ligjore. Gjatë vitit, Këshilli Kombëtar për Siguri dhe Shëndet nuk ka qenë plotësisht funksional dhe ka pasur vetëm rol këshillëdhënës. Përderisa punëtorët kanë të drejtë ligjore të largohen nga situatat që e rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e tyre pa e rrezikuar punësi

Ka pasur mesatarisht 40 viktime në vendin e punës në vit, por pa të dhëna për shkaqet specifike për vdekjet ose lëndimet në vendin e punës.

